



Punime Hulumtuese



15 – 19 SHTATOR
SHKUP, R. E MAQEDONISË

SHKOLLA VERORE “RELIGJIONI, PËRKATËSIA ETNIKE DHE NACIONALIZMI”

Përmbajtja:

▪ Knocking on Heaven’s Door:

Çfarë nënkuptojmë kur mendojmë për llojllojshmërinë religjioze

Grupi i punës 1: *Elinda Stojanova, Daniella Stoilkova, Kristina Dimovska, Zoran Radičeski, Naum Trajanovski*

▪ Elementet konsociative dhe integruese në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë pas nënshkrimit të Marrëveshjes

Kornizë të Ohrit

Grupi i punës 2: *Frosina*

Doninovska, Robert Stefanovski, Valmir Shabani, Ivana Llazaska

▪ Mangësi të multikulturalizmit

Grupi i punës 3: *Viktoria Taseva,*

Dragolub Mukoski, Natasha Ivanoska, Daniel Gjoqeski, Goce Josheski

▪ Multikulturalizmi kundër universalitetit të drejtave të njeriut

Grupi i punës 4: *Marjana Hrisafov,*

Ana Topshiova, Elena Stojkova, Fisnik Jakupi, Tatjana Manojlovska

▪ Uzurpimi i sekularizmit nga religjionet shtetërore?

Grupi i punës 5: *Bogoeva Katalin,*

Gjorgjievski Marko, Stojmenov Aleksandar, Çorlinova Nikolija

▪ Realiteti maqedonas, ndarje etnike ose religjioze

Grupi i punës 6: *Marija Antova,*

Florina Emini, Lucija Kabusha, Filip Tančev

Punimet Hulumtuese të Shkollës Verore 2014



“ Religjioni, Përkatësia Etnike dhe Nacionalizmi”

15–19 shtator
Shkup, Republika e Maqedonisë

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Hyrje:

Më 15 shtator 2014, z-nja Anja Çimek, përfaqësuesi zyrtar i Fondacionit Konrad Adenauer në Shkup dhe profesor dr. Mitko Panov nga Universiteti "Evro-Ballkan" Shkup, hapën shkollën e parë verore që kishte për qëllim të pasqyrojë teorinë dhe hulumtimet më të reja nga tema e religjionit dhe shoqërisë. Shkolla verore pesëditëshe përbëhej nga ligjërata, prezantime, vizita studimore dhe diskutime që ishin të udhëhequra nga akademikë të lartë nga kjo fushë, me theks të veçantë që nëpërmjet programit të shkollës verore të ndiqet zhvillimi i ndryshimeve të paradigmave dhe teorive gjatë dy dekadave të fundit në shoqërinë maqedonase, por edhe në nivelin ndërkombëtar.

Në shoqëritë e ngjashme me ne, që dallohen me llojllojshmëri etnike dhe religjioze, kuptimet e ndryshme të religjionit dhe qytetarisë në periudha të caktuara madje edhe shndërrohen në dhunë fizike dhe konflikte. Sfida e shteteve pluraliste është që gjejë një mënyrë për të zgjeruar strukturat pluralë dhe etikën publike nga njëra fushë në tjetrën me anë të promovimit të mesazheve pluraliste në shkollat dhe me anë të mediave, me anë të zvogëlimit të pabarazisë sociale me të cilën rriten më tepër tensionet e klasave dhe religjioneve dhe të krijohen lidhje mes grupeve të ndara sociale etnike-religjioze.

Për temë të kësaj shkolle verore në vitin 2014 ishte zgjedhur *Religjioni, përkatësia etnike dhe nacionalizmi*. Ishin trajtuar tema lidhur me këto fusha me qëllim të jepet një kontribut për rritjen e nënvetëdijes publike për rolin, domethënien dhe funksionin e profileve të ndryshme kulturore në kushte të realitetit shoqëror, ndërkulturor dhe demokratik të vendit. Në shkollën verore kanë marrë pjesë 40 akademikë të rinj nga gjithë vendi, të cilët kanë pasur mundësi të shkëmbejnë përvojat e tyre, qëndrimet dhe mendimet, por edhe të përfitojnë njohuri të reja.

Pjesëmarrësit kishin mundësinë të jenë të pranishëm në ligjërata, debate të hapura, punëtori, vizita studimore të objekteve fetare dhe kontakte të drejtpërdrejta, me qasje të rrallë ndërdisiplinore të mësimin dhe hulumtimit të problemeve të ndërlikuara me të cilat përballet vendi, me theks të veçantë mbi çështjet që kanë të bëjnë me stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e dialogut multietnik dhe multireligjioz në vend. Dedikimi dhe puna aktive e tyre në këtë shkollë verore rezultoi me hartimin e punimeve në temat të cilat ata kanë konsideruar që janë me interes. Punimet janë dhënë në vazhdim të këtij dokumenti.

Qëndrimet dhe konkluzionet e dhënë në punimet janë vetëm të autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyrojnë qëndrimet dhe konkluzionet e organizatorëve të shkollës verore.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Grupi i punës 1:

Elinda Stojanova
Daniella Stoilkova
Kristina Dimovska
Zoran Radiçeski
Naum Trajanovski

Knocking on Heaven's Door: Çfarë nënkuptojmë kur mendojmë për llojllojshmërinë religjioze

"Në një univers plural, nuk ekziston ekuivalent religjioz në një laborator ajror ku do të strehoheshim për të shmangur historive tona religjioze dhe kulturore. Nuk ekziston këndvështrim nga gjithë ne që jep një perceptim të privilegjuar për gjërat në gjendjen e tyre të vërtetë."¹

1. Diapazoni teorik i nocionit të religjionit

Llojllojshmëria religjioze nuk është një temë bashkëkohore. Interesi për religjionin si sistem i besimeve dhe normave që i ndan një bashkësi ose grup, të bashkuar në besimin në një zot ose më tepër zota ose në fuqi mbinatyrore, ka qenë mjaft aktuale në periudhën e mesjetës. Miroslav Brandt, për shembull, shkruan për kuptimet e para të krishterimit në mesjetë, si "dukuri që ekziston në kohën dhe nëpër atë rrjedh nga e kaluara drejt ardhmërisë", por edhe si dukuri që me vete tërheq edhe hermetizmin, "që nuk shënon asnjë tjetër por vetëm mospajtimet me fenë e drejtë"² Megjithatë, kur flasim llojllojshmërinë religjioze, ne në fakt flasim për ekzistimin e njëkohshëm të sistemeve të ndryshme fetare dhe religjioze të cilat nuk përfshijnë vetëm krishterimin dhe paganizmin, por edhe islamin, budizmin, judaizmin dhe religjionet tjera botërore.

Nga perspektiva krishtere, ata jashtë fesë krishtere dhe religjionin janë përcaktuar, në rastin më të mirë, si "të egër që nuk janë të dritësuar" (ose paganë)³ ose në rastin më të keq, si demonë, ashtu që tentohej ose

¹ Marjorie Hewitt Suckocki, *Divinity and Diversity: a Christian affirmation of Religious Pluralism*, Abingdon Press, Nashville 2003, 15.

² Miroslav Brandt, *Izvori zla*, August Cezarec, Zagreb 1989, 8.

³ Shembull i mirë për këtë ekziston në epin francez *Këngapër Roland*. Në kuptimin lingvistik, trajtimi dhe nomenklatura e Saracënëve, si armiq të Frankëve krishterë dallon, ndërsa për këtë rol të rëndësishëm luan edhe zgjedhja e përkthyesit për terminë ose të lexuesit. Në leximin e Leons Rabijon (1885), shpeshherë përdoren epitetet 'paganë' dhe 'mori' për

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

konvertimi i tyre ose shkatërrimi i tyre. Pogromi krishterë i Hebrenjve dhe Luftërat e Kryqëzimit ishin nisur me qëllim të rikthehet Jerusalemi dhe të ç'rrënjëzohet islami, ndërsa këto janë ndoshta shembujt më flagrante për efektet e motos: "Nuk ekziston shpëtim jashtë kishës". Persekutimi i brendshëm i krishterëve nga ana e krishterëve tjerë në emër të "besimit të vërtetë" ose ajo ortodokse, është një shembull plotësues për stuhitë e mëdha që ka shkaktuar dhe ndikuar llojllojshmëria religjioze.⁴ Ndonëse këto ngjarje janë zhvilluar në Mesjetë, qartë është që dallimet mes sistemeve të ndryshme religjioze dhe religjioze që nuk janë niveluar tërësisht në shekullin XXI. Kjo imponon pyetjen se në çfarë mënyre mund të arrihet komunikimi më produktiv, bashkëjetesë, kuptim dhe respektim jo vetëm në kuptimin religjioz, por edhe racor, etnik dhe popullor.

Religjioni nuk nënkuptohet ekskluzivisht si një besim personal (në zot, hyjni dhe entitete tjera që në përgjithësi kanë natyrë mbinjerëzore) por paraqet edhe një "jashtësi" sistemore dhe intelektuale, gjegjësisht kuptohet si një përmbledhje e sistemeve precize të besimit. Ky koncept ka pasqyruar dhe stimuluar konfliktet religjioze dhe ishte përdorur për të skicuar grupet në sajë të krishterimit dhe të klasifikojë dhe përfshijë atë që ka qenë konsideruar si një fenomen ekuivalent në kulturat jo-krishtere, nga ana e Perëndimit, gjatë periudhës së kolonializmit. "Në përgjithësi, këtyre 'religjioneve' ende nuk ju ishte dhënë një emër specifik por vetëm një fjalë, atyre ju referoheshë në pika të shkurta."⁵Në fund të shekullit XVIII, Fridrih Shllaermarher ka gjallëruar kuptimin e brendshëm dhe intelektual të nocionit të religjionit. Gjatë kësaj periudhe, nocioni "religjion" u ndryshua për të mund të përfshirë edhe "historinë e religjioneve" dhe pikërisht në këtë shekull janë krijuar emrat e religjioneve. Nga ana tjetër, nuk janë të pazakontë ndërlidhjet që vendosen mes religjionit dhe filozofisë. Frideo Riken, për shembull, e argumenton këtë lidhje kur thuhet që qeniet njerëzore janë përfytyrim i Zotit dhe konsiderohen si krijesa të tij. Filozofia e argumenton të njëjtën, por shprehur në një diskurs tjetër, për njerëzit si qenie të lidhura dhe të obliguara nga liria.⁶Andaj, në këtë kuptim, nëse qëllimi i religjionit është të arrihet liria e njeriut në një sistem fetar (ndërsa nuk është e nevojshme robërimi i tij dhe lidhja rigoroze), atëherë duhet të respektohet dhe vlerësohet liria e tjetrit, që është i ngjashëm (ose "pangjashëm", me fjalët e Renate Lahman) siç vlerësohet dhe respektohet liria personale.

Në përmasa botërore, shihet qartë që religjioni nuk konsiderohet vetëm si një sistem i vlerave dhe normave, por edhe si një resurs që ndikon në jetën e njerëzve, dhe shpeshherë i formon dhe ndikon në aktivitetet e

Saracenët ("morët nga Spanja"). Në përkthimin e Xhesi Kroslen (1999), për mbretin Marsije dhe repartin përdoret epiteti "Saracen"/"Saracenë". Në verzionin me rimë, në formë të prozës të O'Hagan, lexuesi shpesh përdor epitetin 'pagan' por edhe përdor referencën 'Saracenë' atje ku Rabijon e përdor termin 'mori'. Të shikohet literatura në fund.

⁴ Marjorie Hewitt Suckocki, *Divinity and Diversity*,16.

⁵ Robert Jackson, "Citizenship, religious and cultural diversity and education", *International Perspectives on Citizenship, Education and Religious Diversity*,ed.R. Jackson, RoutledgeFalmer, London 2008, 7.

⁶ Friedo Ricken, "Postmetaphysical Reason and Religion", *An Awareness of What is Missing: Faith and Reason in a Post-Secular Age*, Polity Press,Cambridge 2010, 52.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

grupeve që formohen në një shoqëri. Dizajnimi i mjedisit të ri institucional të pluralizmit religjioz, siç sugjeron Bader, dhe politika që pohojnë që janë më përkatëse për parimet e ri-konceptualizuar dhe institucione të demokracisë liberale, është një detyrë qartësisht serioze dhe mjaft e ndërlikuar. Pothuaj se a pamundshme është që paralelisht të zgjidhen problemet meta teorike dhe filozofike dhe të bëhet një analizë komparative të institucioneve, politikave dhe rasteve të izoluar me thellësi të njëjtë. Bader, për shembull, preferon një konceptim të a.q. "moral minimal" që duhet respektuar gjithkund dhe që sipas natyrës është e tillë që lejon përshtatjen maksimale të grupeve jo-liberale në politikat demokratike liberale.⁷E dyta, ky aspekt sistematik i lidh diskutimet e reja për pluralizmin institucional në filozofinë politike, me perspektivë më të gjerë shoqërore të udhëheqjes, që deri më tani nuk ka qenë shfrytëzuar për problemet që prekin pakicat etnike, religjioze dhe nacionale. Xhozef Shmit, nga ana tjetër, preferon dialog në të cilën dy palët janë në konflikt religjioz, që do të ishin fitimtarë dhe mbështetjet në qëndrimet e Jirgen Habermas, që bën dallim mes "kuptimit pro-shpirtëror" dhe "besim religjioz". Sipas tij, Habermas, propozon katër punkte kryesore që duhet të përfshihen, për të arritur këtë dialog religjioz që do të jetë përfitim për dy palë, por përse jo edhe për gjithë palët në proces. Parakushti i parë është shërbimi në gjuhë të kuptueshme për dy palët. Parakushti i dytë është respektimi i të vërtetës universale të gatshme dhe obliguese.⁸Parakushti i tretë supozimi për hapje personale, por edhe supozimi për hapje edhe nga ana tjetër. Parakushti i katërt është pranimi i normave të pozicionuar reciprociteti i këtij aktiviteti mendor. "Ndonëse në kuptimin empirik nuk është e mundshme të plotësohen gjitha parakushtet, ajo mund të zbatohet në kuptimin "e shfaqjes"⁹. Kjo, sipas tij, krijon hapësirë për të menduar arsyet për konfliktet religjioze, që njerëzit i kthen në partnerë të barabartë.

Të gjitha çështjet që prekin të vërtetën dhe drejtësinë, pa dallim a shqyrtohet në aspekt të jetës së përditshme ose nga shkenca, ose në organizimin e bashkëveprimeve shoqërore, mund të hulumtohen në spektrin e kësaj kornize refleksive. Të gjitha propozimet, tentimet për përgjigje dhe gjithë mëria e opsioneve të mundshme, mund dhe duhet të shprehen, por fillimisht duhet të njëjtat të tregohen si mjaft të vlefshme për të hyrë në këtë kornizë komunikative. Megjithatë, nëse nuk analizohet kjo në planin praktik, nuk do të mund të dimë efikasitetin dhe efektivitetin e një dialogu të tillë. Vetë Shmit propozon që e gjithë korniza e propozuar ofrohet për të nxitur dialog në të cilën llojllojshmëritë religjioze nuk do të flasin "njëri për tjetrin por njëri me tjetrin" si dialog në të cilën dy palët do të ndjejnë që janë seriozisht të marrë në besimet e tyre. "Vetëm me ushtrim dhe me rrezikimin e përgjegjësisë më personale, feja mund të

⁷ Veit Bader, *Secularism or Democracy? Associational Governance of Religious Diversity*, Amsterdam University Press, Amsterdam, 2007, 22.

⁸ Me siguri këtu mendon për vlerat universale të njeriut dhe interes për çështjet pereniale etike dhe shpirtërore.

⁹ Josef Schmidt, "A Dialogue in Which There Can Only be Winners", *An Awareness of What is Missing: Faith and Reason in a Post-Secular Age*, Polity Press, Cambridge 2010, 60.

SHKOLLA VERORE: “RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI”

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

mbijetojë si një ‘paradoks’ (gjegjesisht si një drejtim kundër ‘doksës’ dhe në kundërshtim të gjithçka që “duket” që është).¹⁰

2. Përvoja praktike nga Shkolla Verore me titullin “Religjioni, përkatësia etnike dhe nacionalizmi”

Pjesëmarrësit e shkollës verore me titullin “Religjioni, përkatësia etnike dhe nacionalizmi” kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në një program të pasur të përgatitur nga Fondacioni “Konrad Adenauer” dhe universiteti “Evro-Ballkan”. Ajo që ishte nxitur nga shkolla verore pesëditëshe si temë e ardhme për të menduar dhe shqyrtuar ishte koncepti i tolerancës si një nocion antietik. Shembujt nga historia, por edhe nga rastet e reja kanë treguar që thirrja për tolerancë zakonisht paraqitet në kohëra të konflikteve të rrepta religjioze dhe jo çdoherë, siç sugjeron Torsten Kanut, është e qartë se cili konceptim i tolerancës përfaqësohet. Sipas tij, kuptimi perëndimor i nocionit ka kaluar në disa metamorfoza gjatë shekujve të fundit, paralelisht e rritjen e pluralizmit në shoqëritë perëndimore. “Një koncept i qëndrueshëm i tolerancës i nënkupton aspektet e mohimit dhe afirmimit në kuptim të vlerave dhe praktikave të tjerave. Koncepti gjithashtu nënkupton edhe komponentë të *përjashtimit praktik*. Pa këtë mohim të pozitive në kuptimin normativ nuk është e arsyetueshme të flitet për tolerancë.”¹¹ Megjithatë, pyetja e vërtetë shtrohet në atë se çfarë mase janë të përgatitura palët e kundërshtuara të marrin pjesë në procesin demokratik të bindjeve religjioze të tjetrit.

Pyetjet dhe dilemat për individualitet religjioz ose për llojlojshmëri religjioze ishin gjithashtu lëndë e dialogut. Në kuadër të shkollës verore, ekipi ynë – në diskutimin fillestar rreth orkestrimit të këtij punimi – ishte vendosur për një metodë të çmendur të analizës. Në vend të nisim me ato klasike, shpeshherë me anketa të lodhshme, vendosëm që pjesëmarrësve të japim shansin të jenë kreativ dhe me anë të asociacionit të përgjigjen në pyetjen: “Trokasin **një krishterë, mysliman dhe hebre** në portën e parajsës. Nga ana tjetër, rojtari pyet: ‘Kush troket?’ Pyetja ishte parashtruar dy grupeve të fokusit. Grupi i parë ishte përbërë nga pjesëmarrësit e shkollës verore (që, për shkak të saktësisë, e emëruam si Fokus Grupi 1), ndërsa grupi i dytë ishte përbërë nga persona të rinj që nuk ishin pjesë e shkollës verore, por që nuk kanë qenë pjesë e ndonjë bashkësie të tillë interaktive (të cilat i emëruam si Fokus Grup 2). Përgjigjet e fituara i ndamë të katër grupe themelore, duke filluar nga të anketuarit që shprehën përqindje më të madhe të ngjashmërisë në përgjigjet dhe duke përfunduar me të anketuarit që shprehën përqindje më të lartë të dallimit.

¹⁰ Josef Schmidt, “A Dialogue in Which There Can Only be Winners”, 71.

¹¹ Thorsten Knauth, “Tolerance - a Key Concept for Dealing with Cultural and Religious Diversity in Education”, 2010,

http://www.theewc.org/uploads/files/State%20of%20the%20Art_Knauth_alt.pdf.

Të


shikohet literatura e referuar në fund.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Shprehur në figurë, rezultati ishte në këtë gjendje:



Në kolonën e parë janë dhënë rezultatet nga të anketuarit që janë përgjigjur pyetjes me ndarjen e një prej llojeve të besimtarëve në frazën e ofruar. Nga rezultatet e marra, vërehet që një pjesë e të anketuarave kanë menduar që asnjëri nuk e ka vendin në parajsë dhe vetëm një lloj i besimtarëve të përmendur në anketën e meriton atë. Në kolonën e dytë janë dhënë rezultatet e të anketuarve që vetë-identifikohen në bazë personale (duke theksuar emrin personal) ose vetë-identifikohen në bazë fetare (duke theksuar religjionin përkatës). Në kolonën e tretë janë dhënë rezultatet e të anketuarve që janë përgjigjur me dallimin e qartë dhe pranimin/përfundimin e llojeve të ofruar të besimtarëve në bazë të përkatësisë së tyre fetare. Në fund, në kolonën e katër janë dhënë rezultatet e të anketuarve që janë përgjigjur me përemrin shumës "ne", që tregon shkrirje të plotë dhe nivelim të dallimeve dhe niveleve të ndryshme të religjioneve përkatëse, gjegjësisht qëllimi përfundimtar është që njerëzit të punojnë në njerëzimin e tyre si diçka që i unifikon dhe jo të llojllojshmërisë religjioze, si diçka që i bashkon. Sipas rezultateve të fituara, rezultati përfundimtar tregoi për një ndikim pozitiv të aktiviteteve që ishin ofruar gjatë kohës së ligjëratave dhe aktiviteteve të shkollës verore dhe ato mund të ndryshojnë perceptimin dhe kuptimin e tjetrit në drejtim pozitiv. Ndikimi i faktorëve tjerë është 17% dhe në kuadër të këtyre faktorëve, një pjesë të madhe përfshin rrethina e përditshme e individit. Me këtë bëhet e qartë efikasiteti në këto aktivitete grupore mes të rinjve në modifikimin e perceptimit të tyre për njerëzit me përkatësi të ndryshme religjioze.

Megjithatë, ndonëse kemi rezultate pozitive të qarta jo vetëm nga anketa, por edhe me pjesëmarrjen aktive në shkollën verore nga ana e pjesëmarrësve, paraqitet dilema në çfarë mase këto ngjarje të organizuara me të rinjtë mund të rezultojnë me ndryshim që do të ishte mjaft e dukshme për të nxitur njerëzit me qëndrime rigide religjioze dhe shpeshherë synojnë stigmatizim të paargumentuar të tjetrit me fe të ndryshme, të ndryshojnë në rrënjë mënyrën e tyre të menduarit.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Përderisa i riu lejon që të joshet nga ana e mediave, ose nga ana e autoriteteve përkatëse, që e retorikë të menduar mirë dhe me filantropi sipërfaqësore flasin për tolerancë dhe për respektim të tjetrit me gjitha spektrat e llojllojshmërisë së tij, ai rrezikon të formojë me qëndrime të gabuara dhe të mbetet në injorancë. Ndërsa, injoranca shpesh shpie drejt bërjes së gabimeve trashanike. Vetëm me anë të praktikimit të vetëdijes si një parim themelor i kuptimit, mund të bëhemi ndryshimi të cilën kërkojmë nga të tjerët.

Bibliografia:

1. Bader, Veit, *Secularism or Democracy? Associational Governance of Religious Diversity*, Amsterdam University Press, 2007.
2. Brandt, Miroslav, *Izvori zla*, Zagreb, August Cezarec, 1989.
3. Crosland, Jesse (trans.) *The Song of Roland*, Cambridge, Ontario, 1999.
4. Jackson, Robert, "Citizenship, religious and cultural diversity and education", *International Perspectives on Citizenship, Education and Religious Diversity*. London, RoutledgeFalmer, 2003.
5. Knauth, Th. (2010) Tolerance - a Key Concept for Dealing With Cultural and Religious Diversity in Education. Available at: http://www.theewc.org/uploads/files/State%20of%20the%20Art_Knauth_alt.pdf [05.01.2011].
6. Lachman, Renate, *Phantasia/Memoria/Rhetorica*, Zagreb, Matica Hrvatska, 2002.
7. O'Hagan, John (trans.), *The Song of Roland*, vol. XLIX, Part 2, New York, P.F. Collier & Son, 1909–14; Bartleby.com, 2001. Достапно на: www.bartleby.com/49/2/. [Date of Printout].
8. Rabillon, Léonce(trans.), *La chanson de Roland: Translated from the Seventh Edition of Leon Gautier*, New York, Henry Holt & Co., 1885.
9. Ricken, Friedo, "Postmetaphysical Reason and Religion", *An Awareness of What is Missing: Faith and Reason in a Post-Secular Age*, Cambridge, Polity Press, 2010.
10. Sayers, Dorothy L. (trans.), *The Song of Roland*, Penguin Classics, 1957.
11. Schmidt, Josef, "A Dialogue in Which There Can Only be Winners", *An Awareness of What is Missing: Faith and Reason in a Post-Secular Age*. Cambridge, Polity Press, 2010.
12. Suckocki, Marjorie Hewitt, *Divinity and Diversity: a Christian affirmation of religious pluralism*, Nashville, Abingdon Press, 2003.
13. O'Hagan, John (trans.) 2001, *The Song of Roland*, vol. XLIX, New York, P.F. Collier & Son, 1909–14; Bartleby.com, 2001. www.bartleby.com/49/2/ [Date of Printout].

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Grupi i punës 2:

Frosina Doninovska,
Robert Stefanovski,
Valmir Shabani,
Ivana Llazeska

Elementet konsociative dhe integruese në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit

Hyrje

Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e nënshkruar pas konfliktit të armatosur në vitin 2001, në masë të madhe ka ndryshuar kornizën kushtetuese të sistemit paraprak politik të vendit. Korniza demokratike e ashtuquajtur Vestminster që ishte themeluar me kushtetutën e vitit 1991 që ka favorizuar shumicën e maqedonasve etnikisht braktisur me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Për shkak të konfliktit të armatosur dhe shtypjes nga komuniteti ndërkombëtar, ishte formuar një model i ri i njohur në teorinë politike si ndarje e pushtetit. Ky model përfshin elemente nga modeli integrues dhe konsociativ të demokracisë. Qëllimi i këtij modeli ka qenë të krijojë paqe ndëretnike, stabilitet më të madh dhe siguri në vend. Modeli i ndarjes së fuqisë është model i përcaktuar nëpërmjet praktikës dhe institucionit, nga të cilat dalin koalicione më të mëdha në pushtet. Këto koalicione në përgjithësi, përfshijnë gjitha grupet më të mëdha etnike në shoqëri. Ky sistem në fakt duhet të shpreh parimet që janë kundërshtuar, si për shembull, e drejta e vetë-përcaktimit nga njëra anë dhe demokracia nga ana tjetër.

Në këtë punim do të mundohemi të japim përgjigje pyetjes se cilat elemente të modelit konsociativ dhe cilat nga modeli integrues të demokracisë janë të përfaqësuar në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë të parashikuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit dhe si ata janë inkorporuar në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë.

Ndarja e pushtetit

Koncepti i ndarjes së pushtetit përbëhet nga dy komponentë të rëndësishme: "pushteti" dhe "ndarja". Secili sistem individual që synon në

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

ndajë resurset në grupe të ndryshme të shoqërisë, e ka fuqinë si synim përfundimtar¹. Koncepti i ndarjes së pushtetit do të thotë që drejtimi i shtetit duhet të jetë i përbashkët, jo vetëm nga një udhëheqësi e ngushtë. Në kushte të krijimit të një sistemi të ndarjes së pushtetit ose studimit të një rasti aktual, me rëndësi është që të sigurojmë që institucioni (zakonisht mendohet për institucionet specifike që janë shprehje e ndarjes së pushtetit) në fakt të ketë pushtet. Komponenti i dytë synon në nocionin që pushteti është i ndarë. Pushteti nuk është i ndarë kur grupet e ndryshme i ndajnë detyrat dhe nuk konsultohen dhe nuk bashkëpunojnë në situatë të marrjes së vendimit. Gjithashtu, në situata kur një grup ka pushtetin dhe i pyet tjerë për këshillë, por mund mos të respektojë këshillin. Ndarja e pushtetit kërkon pajtim nga përfaqësimi i gjerë i grupeve në një sistem të caktuar.²

Ideja e këtij modeli të ndarjes së pushtetit është që gjitha komuniteteve etnike të garantohet përfaqësim politik, shoqëror dhe kulturor si dhe parimi i vetë-shprehjes në kuadër të shtetit maqedonas. Të drejtat e garantuara nuk duhet të jenë vetë nominale, por qytetarët që takojnë komuniteteve më të vogla etnike duhet të kanë mundësi të vërtetë që të gëzojnë ato të drejta³. Sipas kësaj, Marrëveshja Kornizë e Ohrit ishte përqendruar në integrim të plotë të këtyre grupeve etnike pjesëmarrja e të cilëve më herët varej nga vullneti i komunitetit më të madh etnik.

Gjatë tentativave për të definuar ndarjen e pushtetit, marrim parasysh definicionin e dhënë më para nga Arend Lijphart për rregullimin konsocial, që është më e kufizuar në kuptim të ndarjes së pushtetit. Lijphart i thekson pesë kriteret vijuese për rregullim konsocial: (1) koalicioni i madh, gjegjësisht kyçje e gjitha grupeve kryesore në pushtet; (2) përfaqësim proporcional të gjitha grupeve relevante në Kuvend dhe administratë publike; (3) kyçje të grupeve më të mëdha në pushtet; (4) e drejta e vetos; (5) shkallë më të lartë të autonomisë.⁴

Për të bërë dallim mes anës konsociative (ana pozitive e ndarjes së pushtetit) dhe anës negative të ndarjes së pushtetit, duhet që këto nocione të interpretohen më thellë, përveç definicioneve origjinale të dhëna nga Lijphart. Autonomia, për shembull, mund të kuptohet si decentralizim – vegël e ndarjes së pushtetit – pa mos theksuar që decentralizimi pa dyshim do të jetë vetëm "etnike".⁵ Gjithashtu, koalicionet e mëdha do të duhet të jenë të gjera dhe inkluzive (gjithëpërfshirëse), por nuk do të thotë që është

¹Conflict Research Consortium. *Power Sharing and Autonomy Strategies*. University of Colorado. USA, <http://www.colorado.edu/conflict/peace/treatment/powrshar.html>.

²Timothy Sisk, *Power Sharing and International Mediation in Ethnic Conflicts*, Washington, USIP, Washington, 1996.

³Immigration and Refugee Board of Canada, *Macedonia: Implementation of the Framework (Ohrid) Agreement*, 18 July 2003.

⁴ Arend Lijphart, *Democracy in Plural Societies: A Comparative Exploration*, New Haven London, Yale University Press, 1977, 25.

⁵Matthias Bogaards, *Democracy and Power-Sharing in Multinational States*, Jacobs University, Bremen, 122.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

e nevojshme të themelohen parti etnike.⁶Grupet jo-dominuese nuk duhet të kenë patjetër të drejtë absolute të vetos, për shkak të plotësimit të kriterëve që kanë të bëjnë me marrëveshjen e ndarjes së pushtetit. Si plotësim, duhet të kufizohet përfaqësimi proporcional në Kuvend dhe përfaqësimi proporcional në administratën publike. Ajo ndodh sepse dy palët kanë vegla të ndryshme dhe funksione në shoqërinë. Përfaqësimi në administratë ka ndikim të fuqishëm mbi ndjenjën e "pronësisë" që do të mund të zhvillohet tek grupet të pamjaftueshme paraprake të përfaqësuar në vend.⁷

Qasjen e dytë të ndarjes së pushtetit fillimisht ka përmendur Donald Horovic, i cili ka synuar një sistem inkurajues dhe centripetik. Qasja konsociale bazohet mbi premisën që secili grup në një shoqëri duhet të përfaqësohet nga elita e saj, zakonisht të shprehur nëpërmjet një ose më tepër parti. Horovic, nga ana tjetër, synon për një sistem politik që do të inkurajonte bashkëpunim mes bashkësive të ndara etnike. Në këtë formë, sistemi më pak do të përqendrohej në përfaqësim, ndërsa në masë të madhe në përfundim të bashkëpunimit ose paraqitjes së një elite të re më inkluzive. Ky sistem i ndarjes së pushtetit karakterizohet me pesë veçori: a) *Shpërndarja e pushtetit*, gjatë së cilës pushteti nuk duhet të koncentrohet në një vend. Kjo shpërndarje ndalon konflikte më të mëdha; b) *Devoluimi i pushtetit* dhe ndarje të pushtetit që në fakt është orientuar drejt rritjes së bashkëpunimit ndëretnik në nivel lokal dhe ulje të rëndësisë simbolike që është e nevojshme për disa vendime që merren nga instanca më të larta të pushtetit; c) *Përfundimi i bashkëpunimit* me anë të mekanizmave juridik, siç janë ligje zgjedhore për të cilat janë të nevojshme koalicione ndëretnike; ç) *Promovimi i kanaleve ndër-sektoriale*, që do të depërtojnë linjat etnike dhe do të ndihmojnë në theksimin e identitetit etnik në shoqëritë tepër të ndara; d) *Zvogëlimi i dallimeve*, gjatë të cilës fokusi është orientuar drejt ndalimit të përfundimit të dallimeve etnike për shkak të pabarazive tjera.⁸

Ndarja konsociale e pushtetit supozon që përfaqësimi i grupeve relevante nga ana e elitës përkatës dhe autonomia e madhe janë çelësi i bashkëjetesës së suksesshme ndëretnike. Ndarja centripetike e pushtetit potencon nevojën për të krijuar një dinamikë institucionale që do të ndalojë etnifikimin e sistemit politik dhe do të rezultojë me një elitë më të integruar. Dy qasjes përmbajnë shumë rreziqe. Ndarja konsociale e pushtetit përfshin rrezik të përfundimit të ndarjeve etnike dhe do të bëjë përkatësinë etnike një element kryesor ose së paku dominues për identifikim. Si rezultat, mund të përkeqësohen marrëdhëniet ndëretnike, për të cilat në fakt bëhen përpjekje për të rregulluar.⁹Konsocializmi është më i përshtatshëm për shoqëritë tepër të ndara në të cilat identiteti etnik

⁶ Florian Bieber, *Power-Sharing and Implementation of the Ohrid Framework Agreement*, Friedrich Ebert Stiftung, Skopje 2008, 10-11.

⁷ Ibid.

⁸ Donald Horowitz, *Ethnic Groups in Conflict*, (Berkeley: University of California Press, 1985), 653.

⁹ Brendan O'Leary, "Debating Consociational Politics: Normative and Explanatory Arguments." *From Power-Sharing to Democracy: Post-Conflict Institutions in Ethnically Divided Societies*, ed. S. J. R. Noel, Toronto: McGill-Queens University Press, 3.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

është tepër i rëndësishëm¹⁰. Ndarja centripetike e pushtetit përfshin rrezik që grupet e minoriteteve më tepër të jenë pjesëmarrës nga anash sepse të jenë të integruar. Nëse nuk ka nivel të njëjtë të përfaqësimit dhe përfshirje si në rregullimin konsocial, grupet e minoriteteve do të ndjehen si të marginalizuar.¹¹

Produkt nga Marrëveshje Kornizë e Ohrit

Marrëveshja Kornizë e Ohrit e ndryshoi Maqedoninë në shtet të përcaktuar nacional me koalicion të madh joformal, në shtet që qëndron e ngecur mes asaj të jetë shtet nacional, qytetar ose shtet dy-nacional me strukturë formale të ndarjes së pushtetit.¹² E nënshkruar më 13 gusht 2001 në Ohër, nga ane partive kryesore maqedonase dhe shqiptare nën udhëheqjen e ndërmjetësuesve ndërkombëtar të BE-së dhe SHBA-ve, Marrëveshja Kornizë e Ohrit propozon një proces ambicioz të reformave juridike të kombinuar me masa sigurie. Qëllimi ishte të ndërpritet kryengritja e UÇK-së dhe rajonet në konflikt të vendosen nën kontrollin e pushtetit.¹³

Me anë të reformave janë bërë përpjekje që të përforcohet edhe natyra qytetare e shtetit dhe të tejkalohet drejtimi eksplicit ndaj grupeve të caktuara etnike. Në kohën e njëjtë, marrëveshja ka përfshirë edhe elemente kryesore të ndarjes së pushtetit, duke ngritur shqiptarët si komunitet me të drejta të ngjashme me komunitetin shumicë maqedonase.¹⁴ Nuk mbeti shumë hapësirë për të mbrojtur komunitetet më të vogla. Si marrëveshje që është posaçërisht i nënshkruar mes partive shqiptare dhe maqedonase për të ndaluar sulmet e kryengritësve të UÇK-së dhe marrëveshja e armatës dhe policisë në pranverë dhe verë të vitit 2001, Marrëveshja ndihmoi që të përforcohet pjesëmarrja e komunitetit shqiptar. Sipas kësaj, Marrëveshja e Ohrit mund të vështrohet si një marrëveshje me të cilën arritëm në përgjigjen e popullatës së pakënaqur shqiptare, ndërsa në njëjtë, u përshpejtua transformimi i shtetit dy-nacional i Maqedonisë.¹⁵

¹⁰ Ibid.

¹¹ Florian Bieber, *Power-Sharing and Implementation of the Ohrid Framework Agreement*, 14.

¹² Ibid.

¹³ Mirjana Maleska, "What kind of a political system did Macedonia get after the Ohrid Peace Agreement?", *New Balkan Politics* Vol 9, (2005), 5-14.

¹⁴ Lidija Hristova, "Democratic Consolidation of Divided Societies. The Macedonian Case", *New Balkan Politics*, Vol 9 (2005), 14-23.

¹⁵ "Globalization, Democracy and Constitutional Engineering as Mechanism for Resolving Ethnic Conflicts", VII-th World Congress of Constitutional Law, Athens, 2007, [http://www.enelsyn.gr/en/workshops/workshop6\(en\).htm](http://www.enelsyn.gr/en/workshops/workshop6(en).htm).

Elementet konsociale dhe integruese në sistemin politik të R së Maqedonisë

Në sistemin politik të Republikës së Maqedonisë që ishte krijuar me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, qasja konsociale e ndarjes së pushtetit mund të vërehet në përdorimin e parimit të shumicës së dyfishtë, gjegjësisht shumicës së Badinterit (e përbërë nga shumica e votave në Kuvend dhe shumicës së votave nga përfaqësues të minoriteteve) për fushat kryesore të ligjvënies, pastaj themelimi i përfaqësimit reciprok në administratën publike në nivelin nacional dhe lokal.¹⁶ Propozimi për vende të garantuara të komuniteteve të vogla në Kuvend është gjithashtu një karakteristikë e qasjes konsociale.¹⁷

Parimi integruer i ndarjes së pushtetit është përfaqësuar në rritjen e domethënies së konfliktit brenda-etnik, kështu që nëpërmjet rritjes së luftës politike brenda, mes partive që janë në një bllok politik, gjegjësisht parti të një komuniteti etnik, paraqet zgjidhje përkatëse për përforcimin e demokracisë me anë të luftës politike, gjegjësisht paraqitjes së partisë në pushtet dhe në opozitë si dhe në bllokun politik shqiptar.

Përforcimi i bashkëpunimit ndëretnik paraqet një karakteristikë tjetër të qasjes integruese. Donald Horovic rekomandon krijimin e pikave shumëzuese të pushtetit me anë të cilave konfliktet etnike shumëzohen sipas niveleve, por zbuten për nga intensiteti. Si shembull të kësaj në R e Maqedonisë mund të merret procesi i decentralizimit.

Konkluzion:

Modeli i ndarjes së pushtetit që është rezultat i krizës luftarake dhe marrëveshjes paqësore me të cilën përmylli konfliktin e armatosur, gjegjësisht e njeh ndarjen e shoqërisë në linja etnike. Në kohën e njëjtë, ky model paraqet një tentim të zvogëlimit të nyjës etnike. Modeli i ndarjes së pushtetit përmban zgjidhje të cilat mund të përdoren për dy qëllime: për integrim të vendit si dhe për çintegrim nëse keqpërdoret. Suksesi varet nga qëndrimet e matura të qytetarëve, fillimisht qëndrimet e politikanëve dhe dedikimi i tyre për vlerat e të drejtave të njeriut dhe liritë në vend të 'kauzës nacionale' të tyre. Për shembull, e drejta e vetos që është parashikuar me Kushtetutë në lidhje me çështjet e zhvillimit të kulturave nacionale dhe identitete të komuniteteve etnike, por edhe për çështje territoriale (për shembull, çështja e kufijve të komunave, është e drejtë që mund të keqpërdoret dhe mund të shkaktojë bllokime në procesin e marrjes së vendimeve, me të cilën krijohet krizë si në nivelin nacional, ashtu edhe në atë komunal. Rreziku është që vetoja e minoriteteve mund të

¹⁶ Florian Bieber, "Institutionalizing Ethnicity in the Western Balkans: Managing Change in Deeply Divided Societies", *ECMI Working Paper*, No. 19, February 2004, http://www.ecmi.de/uploads/tx_lfpubdb/working_paper_19.pdf

¹⁷ Zoran ilievski, *Integrative Theory of Donald Horowitz and its Application in the Republic of Macedonia*, Faculty of Law "Justinijan Prvi", Skopje 2008, 159-160.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

keqpërdoret nëse shpeshherë përdoret si instrument i realizimit të politikave nacionaliste.

Nga ana tjetër, do të ishte problem edhe nëse shumica në mënyrë të hapur ose heshtur i injoron nevojat e minoriteteve, ndërsa si rezultat e asaj vije tek pengimi i integritetit të tyre në shoqëri.

Pjesa më e madhe e qytetarëve, maqedonas, shqiptarë dhe tjerë tregojnë që çështja më e rëndësishme me të cilën përballohen, në masë të madhe, është papunësia, dhe jo ajo etnike. Megjithatë, përkatësia etnike, nga ana tjetër është shumë e rëndësishme për qytetarët. Shumë maqedonas Marrëveshjen e konsiderojnë si një "humbje", për "fitimin" e shqiptarëve. Interesant është që si mund një marrëveshje siç është Marrëveshja Kornizë e Ohrit nuk vlerësohet pozitivisht nga gjitha palët e përfshira. Në rastin me Maqedoninë, me Marrëveshjen është arritur një shkallë e stabilitetit dhe sigurisë, dhe gjithashtu ishte ndaluar edhe ndarja territoriale e vendit. Ajo ishte një fitim për gjithë. Sidoqoftë, Marrëveshja vështrrohet si një lojë me shumë zero, gjatë të cilës fitimi për njërin nga komunitetet padyshim duhet të nënkuptojë humbje për palën tjetër.

Me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit nuk u themelua asnjë formë e re e autonomisë grupore, madje as mundësi për të bashkuar interesat e komuniteteve jashtë partive politike. Dominimi i partive politike në sferën e marrëdhënieve ndëretnike krijoi mjaft probleme. Fillimisht, ajo ka politizuar çdo formë të dialogut ndëretnik dhe ndalon shprehjen e interesave jopartiake për komunitetin. E dyta, shpeshherë transformon përfaqësimin etnik në institucionet, në përfaqësim partiak që rezulton me diskriminim të brendshëm etnik.

Mbetet kontrovers fakti se çfarë sistemi të ndarjes së pushtetit vendoset me MKO-në. Marrëveshja nuk është thjeshtë një kategori e rregullimit institucional të shtetit shumë etnik. Me këtë jepet mundësi për interpretim të ndryshëm dhe kundërshtues të vendosjet institucionale dhe "frymëzimit".

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Bibliografia:

1. Conflict Research Consortium. *Power Sharing and Autonomy Strategies*. University of Colorado. USA, <http://www.colorado.edu/conflict/peace/treatment/powrshar.htm>.
2. Timothy Sisk, *Power Sharing and International Mediation in Ethnic Conflicts*, Washington, USIP, Washington, 1996.
3. Immigration and Refugee Board of Canada, Macedonia. *Implementation of the Framework (Ohrid) Agreement*. 2003.
4. Arend Lijphart, *Democracy in Plural Societies: A Comparative Exploration*. Yale University Press., 1977.
5. Matthijias Bogaards, *Democracy and Power-Sharing in Multinational States*. Jacobs University, Bremen.
6. Florian Bieber, *Power-Sharing and Implementation of the Ohrid Framework Agreement*, Friedrich Ebert Stiftung, 2008.
7. Donald Horowitz. *Ethnic Groups in Conflict*. Berkeley: University of California Press, 1985.
8. Brendan O'Leary, "Debating Consociational Politics: Normative and Explanatory Arguments." *From Power-Sharing to Democracy: Post-Conflict Institutions in Ethnically Divided Societies*, ed. S. J. R. Noel, Toronto: McGill-Queens University Press, 3.
9. Mirjana Maleska, "What kind of a political system did Macedonia get after the Ohrid Peace Agreement?", *New Balkan Politics* Vol 9, (2005), 5-14.
10. Lidija Hristova, "Democratic Consolidation of Divided Societies. The Macedonian Case", *New Balkan Politics*, Vol 9 (2005), 14-23.
11. Gordana Siljanovska, "Globalization, Democracy and Constitutional Engineering as Mechanism for Resolving Ethnic Conflicts", VII-th World Congress of Constitutional Law, Athens, 2007, [http://www.enelsyn.gr/en/workshops/workshop6\(en\).htm](http://www.enelsyn.gr/en/workshops/workshop6(en).htm).
12. Gordana Siljanovska. *Democracy in Multiethnic and Multicultural Society*. Law Faculty "Iustinianus Primus" and Lomonosov University, Skopje – Moscow. 2006.
13. Biljana Vankovska. *The Role of the Ohrid Framework Agreement and the Peace Process in Macedonia*. University of Skopje and Macedonian Helsinki Committee 2006.
14. Florian Bieber, "Institutionalizing Ethnicity in the Western Balkans: Managing Change in Deeply Divided Societies", *ECMI Working Paper*, No. 19, February 2004, http://www.ecmi.de/uploads/tx_ifpubdb/working_paper_19.pdf
15. Zoran Ilievski. *Integrative Theory of Donald Horowitz and its Application in the Republic of Macedonia*. Faculty of Law "Justinijan Prvi", Skopje. 2008.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Grupi i punës 3:

Viktoria Taseva Dragolub Mukoski Natasha Ivanoska Daniel
GjoeskiGoce Josheski

Mangësi të multikulturalizmit

Hyrje

Si proces politik multikulturalizmi përshkruan një sërë politikash që kanë për qëllim menaxhim të llojllojshmërive që rezultojnë me grupimin dhe formimin e blloqeve etnike brenda një shteti. Prandaj një gjë çdoherë është e pakontestueshme kur bëhet fjalë për multikulturalizmin: elitat në çdo kulturë çdoherë përbëhen nga vizionet e tyre për atë se çfarë ata mendojnë që është multikulturalizëm.

Tema qendror që përpunohet në gjitha format e multikulturalizmit janë identiteti individual dhe/ose kolektiv, që në shoqëritë e ndërlikuar ose heterogjene siç e kemi ne është çdoherë i përcaktuar me dialog të gjërave që të tjerët me ndikim duan të shohin tek ne.

Termi multikulturalizëm ka pësuar një debat të gjerë për vendin e tij dhe për rëndësinë në diskursin politik të perëndimit si dhe në mesin e qarqeve akademike. Politikanët e shpallën si projekt i vdekur¹ që inkurajon segregacionin e brendshëm, por nga ana tjetër qarët akademike fokusin e tyre e drejtuan kah krijimi i kornizës institucionale me të cilën do të mundësohet avancim në barazinë kulturore, integrimin dhe relacionet pozitive mes grupeve të ndryshme.

¹Në vitin 2010, Kancelaria Gjermane Angela Merkel në drejtimin e saj para rinisë së Unionit Krishterë- Demokratik theksoi që koncepti "multi-kulti" ku njerëzit "duhet të jetojnë njëri përkaj tjetrit" – është një projekt i dështuar. Mbi këtë deklaratë ndërlidhet edhe Herst Zehofer duke e shpallur konceptin për të vdekur. <http://www.bbc.com/news/world-europe-11559451>

Kryeministri britanik Dejvid Kamerun në pjesëmarrjen e tij në konferencë sigurie në Muni deklaroj që multikulturalizmi është një projekt i dështuar dhe që Britania ka nevojë për të një identitet të fuqishëm nacional që do të mbronte qytetarët nga çdo lloj i ekstremizmit. „British prime minister: Multiculturalism has failed“, *NCBNEWS*, 2.06.2011, http://www.nbcnews.com/id/41444364/ns/world_news-europe/t/british-pm-multiculturalism-has-failed/#.VCSjzZSSz0B

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Si Amartija Sen²dhe Samuel Hantington³ vështrojnë multikulturalizmin

Amartija Sen vështron multikulturalizmin si një formë tjetër e kolektivizmit me të cilën, ngjashëm me gjitha format tjera të kolektivizmit, të drejtat dhe nevojat e individit janë në nivel të dytë për dallim nga ato të grupit shoqëror. Sen thekson që përmbyllja e personave në identitete të thyeshme e refuzon dimensionin dinamik të ndërtimit të identitetit. Individu identifikohet me kolektivin sepse e humb qëndrimin personal, humbet ajo "unë" ndërsa liria dhe vetë-zhvillimi personal vihen në pikëpyetje.

Duke shikuar me rezervë dhe me një pikë dyshimi ndaj multikulturalizmit Sen konsideron që identitetit i njeriut në asnjë rast nuk mund të formohet vetëm me anëtarësim në një grup shoqëror, nga arsye që njerëzit identifikohen vetëm me mongrupin e tyre, ata nuk arrijnë të njohin të drejtat dhe integritetin e anëtarëve të grupeve tjera. Kjo padyshim shpie jo vetëm drejtë "minijaturizim" të njerëzimit, por edhe i bën dhunën dhe konfliktet më të mundshme madje edhe të pranueshme me arsyetimin që njerëzit në fund të fundit edhe nuk janë të detyruar të pajtohen me qëllimin përfundimtar të jetës.

Madje më tepër, Sen thekson që politikat e multikulturalizmit mund të maskojnë llojet tjera të pabarazisë të cilat paraqiten mes grupeve, veçanërisht duke theksuar pabarazinë ekonomike.

Samuel Hantington në veprën e tij "Përleshja e civilizimeve"⁴ thotë që SHBA-të me shumë civilizime nuk do të jenë Shtetet e Bashkuara të Amerikës por do të ngjajë më tepër Kombeve të Bashkuara.

Duke kritikuar multikulturalizmin, Hantington sfidon elementin qendror të asaj që quhet konfesionin amerikan. Hantington thotë, konfesionin amerikan, për të cilën shumica e amerikanëve janë dakord janë: liria, demokracia, individualizmi, barazia para ligjit, konstitucionalizmi dhe pronësia private. Ai beson që multikulturalizmi është zëvendësim efikas për të drejtat e individit dhe të drejtat e grupeve, të përcaktuar kryesisht në kuptim të racës, përkatësisë etnike, gjinisë dhe orientimit seksual.

Hantington në veprën e tij përmend që më të rëndësishëm nga demografia dhe ekonomia janë problemet lidhur me uljen moralit, vetëvrasjes kulturore dhe përçarjes politike. Multikulturalizmi synon të refuzojë asimilimin në dobi të pranimi të kulturave të ndara që jetojnë bashkë. Në fund, jepet konkluzioni që nëse nuk arrihet asimilimi në SHBA, do të mbetet një shtet i ndarë në dy ose tre kultura dominuese me potencial të madh për përleshje dhe përçarje të brendshme.

² http://en.wikipedia.org/wiki/Amartya_Sen

³ http://en.wikipedia.org/wiki/Samuel_P._Huntington

⁴ http://en.wikipedia.org/wiki/Clash_of_Civilizations

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Modeli i multikulturalizmit në Maqedoni

Teoricienët progresiv me të drejtë kanë pohuar që multikulturalizmi si koncept jo vetëm që nuk ka arritur të balancojë spektrin e theksuar të llojllojshmërisë kulturore, por edhe për shkak të theksimit të panevojshëm të veçorive të ndryshme kulturore, ka shërbyer për të ndarë, edhe gjatë kësaj, të dobësojë njerëzit që kanë interes të përbashkët ekonomik në zbutjen e varfërisë dhe promovimin e reformave sociale.

Kritika e tyre me siguri ka rëndësi të qëndrueshme sepse në të vërtetë multikulturalizmi për shkak të mungesave të saja ka arritur të përgjigjet në mënyrë adekuate interesave të grupeve të jo-privileguara të cilët përballohen me problemin e diskriminimit klasor të krijuar për shkak të pushtetit të pabarabartë në kuptim të qasjes në resurse ekonomike dhe politike. Po ashtu, paraqitet një brengë për atë se në çfarë shkalle multikulturalizmi inkurajon këto grupe të jo-privileguara të kërkojnë përparim me anë të agresivitetit kulturor dhe etnik, në vend të luftës legjitime për drejtësi sociale, nga arsye që, jo shpeshherë grupet e minoriteteve janë përballuar me vështirësi për njohjen e tyre kulturore, etnike dhe në planin ekonomik dhe politik të ndërmarrin masa me të cilat në mënyrë paradoksale e bëjnë konfliktin mes tyre dhe shumicës madje edhe më të mundshëm. Nga kjo, të dhënat për shoqëri multikulturore si shoqëri të ndara me konflikte ndëretnike madje edhe nuk është për surprizë.

Një shembull përkatës është konflikti i armatosur nga viti 2001 dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit⁵ që atëherë dukej si zgjedhja më e mirë për të ndaluar trazirat shtatëmuajshe⁶; marrëveshje me të cilën duhej të vendoset korniza për bashkëjetesë etnike dhe harmonizim të marrëdhënieve. Në vend të krijimit të një shoqërie multikulturore në të cilën do të kristalizohet jeta e llojllojshme sociale mes qytetarëve të grupeve të ndryshme etnike, ishin vizatuar harta demografike⁷ të grupeve etnike (dhe religjioze) që e ndërlikuan më tepër problemin në kuptimin etnik.

Në realitetin e sotëm përballohemi me degradim dhe tjetërsim të "komunitetit-nikoqir" si rezultat i të drejtave "kolektive", "të posaçme" dhe trajtimi preferues i grupeve që në të kaluarën kanë qenë një nivel më poshtë dhe ajo bën që në kuptimin pluralist të jemi të ndjeshëm dhe mos të besojmë që ka një bazë neutrale mbi të cilat njerëzit e kulturave të ndryshme mund të mbijetojnë dhe të bashkëjetojnë në paqe.

Që multikulturalizmi është vetëm legjendë, iluzion do të pajtohen edhe liberalët të cilës përskaj përpjekjeve të përputhjes së liberalizmit me multikulturalizmin në idenë e qytetarisë multikulturore, aludojnë në atë që ky model mund të siguron mbështetje të kufizuar për llojllojshmërinë e bashkësisë, sepse nuk ekziston një shqyrtim i caktuar për atë se në çfarë

⁵ http://en.wikipedia.org/wiki/Ohrid_Agreement

⁶ <http://www.globalsecurity.org/military/world/war/macedonia.htm>

⁷ http://en.wikipedia.org/wiki/Municipalities_of_the_Republic_of_Macedonia

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

mase multikulturalizmi duhet të kalojë në pranim pozitiv të llojeve të ndryshme të komunitetit.

Madje ata edhe paralajmërojnë që shoqëritë tepër të theksuara multikulturore mund të cenojnë lirinë e individit dhe të shkaktojnë një çarje shoqërore të ndjekur me jo-stabilitet politik dhe kuptohet dhunë.

Konkluzion

Kërkimi për bazën e multikulturalizmit rezultoi me një kundërshtuese mes terisë multikulturore dhe shoqërisë maqedonase. Në shoqërinë multikulturore ende shikohet si një "qepje" të religjioneve të ndryshme, grupe etnike, grupe kulturore dhe gjithë këto grupe kolektive janë të përcaktuar nga vetvetja dhe gjithë funksionojnë pa mos referuar nga njëra në tjetrën.

Ideja për një shoqëri multikulturore sjell ndjenjën e bashkësisë që kontribuon identiteti individual të shkelet. Fakti që vendoset një theks i madh në të drejtat kolektive, ndërsa në prapavijë lihen të drejtat individuale dhe shkakton rritje të nyjës. Pa dyshim është që duhet të krijohet një sistem që do të vendos individin sërish në skenë, që nuk do të lejojë në emër të të drejtës kolektive të dëmtohen të drejtat individuale. Një koncept që nuk do të krijojë botë paralele mes gupeve të ndryshme kulturore por do të promovojë liri të përgjithshme dhe të drejtaqë të mund gupet të sigurohet që "pala tjetër" nuk ka për qëllim të dëmtojë dhe ajo të piqet në një sistem në të cilin do të jetojnë bashkë jo duke toleruar njëri-tjetrin por duke jetuar bashkë.

Bibliografi

1. Merkel says German multicultural society has failed
<http://www.bbc.com/news/world-europe-11559451>
2. „British prime minister: Multiculturalism has failed“, *NCBNEWS*, 2.06.2011, http://www.nbcnews.com/id/41444364/ns/world_news-europe/t/british-pm-multiculturalism-has-failed/#.VCsizZSSz0B

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Grupi i punës 4:

Marjana Hrisafov
Ana Topshiova
Elena Stojkova
Fisnik Jakupi
Tatjana Manojlovska

Multikulturalizmi kundër universalitetit të të drejtave të njeriut

Hyrje

Të drejtat e njeriut janë përfitim universal i historisë së njeriut që janë ndërtuar dhe zhvilluar duke kaluar nëpër faza të ndryshme dhe rrethana. Duke filluar nga periudha e shekullit 18 dhe 19, shteti ngadalë rritet në një entitet që duhet të garantojë dhe promovojë parimin e barazisë. Janë miratuar konventa të ndryshme, karta, preambula dhe janë përcaktuar nga ana e organizatave ndërkombëtare dhe organe tjera që kanë konfirmuar rolin e të drejtave themelore. Jo rastësisht janë themeluar edhe gjykatat ndërkombëtare që përveç ato shtetërore, kanë për qëllim të parandalojnë edhe moszbatimin ose mungesën e zgjidhjes së rastit, dhe në fund madje edhe shkelje të tyre.

Në shekullin 20, me proceset e emigrimit, imigrimit dhe kërkimit të perspektivave më të mira për jetë ka mundur që gjitha shtetet të kanë përbërje të ndryshme etnike, gjegjësisht mos të ketë ndonjë shtet që nuk ka grupin e minoriteteve. Pastaj, të drejtat universale të njeriut nuk janë masë për lirinë, detyrimisht u paraqit nevoja për të drejta kolektive që do të avancojnë pozitën e minoriteteve në kuadër të shoqërive, por edhe do të përmirësojnë përfshirjen e tyre në gjitha fushat, fillimisht atë politike. Multikulturalizmi u bë një prej përfitimeve të funksionimit bashkëkohor të shteteve, pa atë si parim, shoqëritë janë ekspozuar në turbulenca dhe ndryshime të fuqishme politike. Në këtë punim, Republika e Maqedonisë është marrë si shembuj i një vendi që ka kaluar e sukses të dy fazat për të arritur paqen, mirëqenien, barazinë dhe bashkëpunimin mes individëve por edhe mes grupeve etnike.

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Përcaktimi i të drejtave të njeriut si një përfitim universal i njerëzimit

Vetë nocioni "universale" nënkupton diçka që ju takon të gjithëve dhe është e përbashkët për të gjithë, ashtu që të drejtat universale të njeriut kanë të bëjë me çdo individ pa dallim moshë, gjinia, vendbanimi, përkatësia e statusit, etj.¹

Nga ana tjetër, konventat që ishin miratuar nga ana e organeve të ndryshme politike dhe organizata gjatë viteve kanë pasur qëllim të përcaktojnë domethënien e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e tyre universal, por gjatë kësaj këto konventa kanë qenë si burime për përcaktimin e ligjeve nacionale ose lloj tjetër të normave me të cilat vendi i të drejtave të njeriut u vendos nën krahët e aparatit shtetëror. Organizatat ndërkombëtare dhe gjykatat e themeluara i mbrojnë të drejtat e qytetarëve nga keqtrajtimi shtetëror dhe garantojnë që shteti-shkelës do të ndëshkohet në mënyrë përkatëse.²

Karta e Madhe për të Drejtat (Magna Carta Libertatum)

Një prej dokumenteve më të para dhe më të rëndësishme që përcakton të drejtat e njeriut është Karta e Madhe për të Drejtat (Magna Carta Libertatum) e vitit 1215. Kjo kartë është një prej dokumenteve kryesore të miratuara në historinë e njerëzimit që kanë shtruar rrugën të asaj që sot quhet sundimi kushtetues (sundim i kufizuar me ligji). Arsyeja e përgjithshme për të cilën ky dokument është përpiluar është mospajtime mes papës Inokentij, mbretit Xhon dhe baronëve për të drejtat e mbretit që është ngushtuar nga luftërat dhe ka rritur për shumëfish tatimet.

Kjo kartë është e rëndësishme për universalitetin e të drejtave të njeriut sepse për herë të parë një vullnet njerëzor (mbretëror) është kufizuar me fuqinë e ligjit, ligji është ajo që do të garantojë të drejtën dhe jo ai që posedon pushtetin.

Pikat kryesore që mund të nxjerrim nga ky dokument janë:

- E drejta e gjithë qytetarëve të lirë të posedojnë pronë, por edhe të trashëgojnë. (Në atë kohë, e gjithë pronë ka qenë e mbretit dhe ai ka vendosur se kujt i jep pronë dhe kujt jo, pas vdekjes ai që ka poseduar pronë sërish ju është kthyer mbretit);
- E drejta e mbrojtjes nga tatimet tepër të larta (nuk mund mbreti të rrit tatimet në pakufi, duhet të ekzistojë ndonjë ligj që do të kufizojë atë);

¹ Richard Pierre Claude and Weston H. Burns. *Human Rights in the World Community: Issues And Action*. University of Pennsylvania Press, 2006.

² Eva Brems. *Human Rights: Universality and Diversity*. Martinus Nijhoff Publishers, 2001.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

- Janë vendosur parimet që të gjithë para ligjit janë të barabartë pa dallim nga karakteristikat personale dhe statusit dhe që procedura gjyqësore është e njëjtë për të gjithë.³

Bill of rights (Ligji mbi të drejtat)

Më lartë përmendëm që jo vetëm kushtetuta por edhe Ligji mbi të Drejtat përshihet nën konceptin e universalitetit të të drejtave të njeriut. Atë menjëherë mund të vërejmë në pjesën hyrëse ku është theksuar që dokumentin e kanë miratuar dhe nënshkruar përfaqësues të popullit të "mirë" të Virxhinisë pa mos përmendur se cili grup etnik ka qenë. Gjatë kësaj, të drejtat e shprehura me Ligjin kanë të bëjnë me Popullin dhe trashëgimin e tyre dhe kanë për të qëllim të vendosin themelet e sundimit.⁴

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut është miratuar më 10 dhjetor 1948 si rezultat i përvojës nga Lufta e Dytë Botërore. Qëllimi i OKB-së është që krimet që janë bërë asnjëherë mos të përsëriten, andaj liderët botëror marrin vendim për të krijuar një dokument që do të garantojë të drejtat e njerëzve pa dallim në rruzullin tokësor. Përpilimi i dokumentit nga teksti fillestar deri në formulimin e deklaratës si dokument final ka zgjatur 2 vit edhe në kushte kur fillon edhe Lufta e Ftohtë dhe bota ishte ndarë në Bllokun Lindor dhe Perëndimor.⁵

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Pas miratimit të Deklaratës Universale nga ana e Kombeve të Bashkuara, vendet anëtare të Këshillit të Evropës ishin të mendimit që duhet të arrihet unitet më i madh mes anëtarëve dhe ajo mund të arrihet vetëm me mbrojtje dhe zhvillim të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Me Konventën ata konfirmojnë lidhjen e thellë me liritë themelore dhe të drejtat që japin themelet e drejtësisë dhe paqes në botë dhe mbrojtja e tyre është një themel i demokracisë politike. Meqë vendet evropiane ndajnë trashëgimi të përbashkët dhe histori dhe ideale, por jo edhe tradita

³ "Magna carta (The Great Charter)", <http://www.constitution.org/eng/magnacar.htm>, accessed 09.21, 2014.

⁴ Virginia. *The Constitution of Virginia: Together with the Virginia Bill of Rights, Passed June 12, 1776*. Printed at the office of the New nation, 1867.

⁵ "The Universal Declaration of Human Rights."

<http://www.un.org/en/documents/udhr/>, Accessed 09.21, 2014.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

politike, duhet të bëhen hapat e para për garantim kolektiv të të drejtave përkatëse të përcaktuar me Deklaratën Universale.

Multikulturalizmi

Pjesa më e madhe e rreth dyqind shteteve që sot ekzistojnë janë multietnike, gjegjësit nuk ekziston shtet ku nuk ka dallime kulturore. Për marrëdhëniet mes grupeve etnike mazhorancë dhe minoritet në demokracitë bashkëkohore, Kimlika do të konstatojë:

*"Minoritetet dhe mazhoranca gjithnjë e më tepër përballen rreth temave si: të drejtat për gjuhën, programi arsimor, autonomia rajonale, përfaqësimi politik, kërkesat territoriale, integrim, politikë natyralizimi, simbole nacionale, zgjedhje e himnit nacional si dhe festat nacionale. Gjetja e përgjigjeve morale dhe politikisht të pranuar të këtyre temave është sfida më e madhe me të cilën përballohen demokracitë"*⁶

Sfida e multikulturalizmit sot është të krijojë një sistem të qetë që do të inkorporojë dallimet etnike dhe kulturore dhe një prej mënyrave më të shpeshta që shtetet e bëjnë këtë është mbrojtja e të drejtave individuale qytetare dhe politike. Megjithatë, ekziston edhe një qasje që gjithnjë e më tepër vende kanë filluar të praktikojnë, që do të thotë se përveç të drejtat individuale që janë të garantuar për secilin në veçanti, të përcaktohen edhe një sërë të drejtash grupore të cilat i kanë pjesëtarët e kulturës specifike.

Vetëdrejtim

Në kuadër të më tepër shteteve multietnike, grupet më të mëdha etnike konsiderojnë që vetëm vetëdrejtimi do të ndihmojë për të plotësuar interesat e komunitetit dhe nëpërmjet kësaj më e miri do të inkorporohen pjesëtarët e grupit. Si një formë të vetëdrejtimit, disa prej komuniteteve etnike, kërkojnë edhe ndarjen dhe pavarësimin duke menduar që gjatë kësaj interesat e tyre assesi nuk do të mund të realizohen në sajë të një shteti të madh.

Të drejta polietnike

Kjo qasje konsideron që emigrantët duhet të largojnë anash përkatësinë e tyre etnike dhe karakteristika që ajo i bart dhe të pranojnë rregullat, zakonet dhe normat të cilat praktikohen në endin në të cilin kanë emigruar.⁷

⁶ Will Kymlicka, "Immigration, citizenship, multiculturalism: exploring the links", *Political Quarterly*, Vol. 74 (2003), 195-208.

⁷ Ibid.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Megjithatë, kjo qasje në praktikë doli mjaft e pasuksesshme sepse ndonëse feja ishte ndarë nga politika, gjegjësisht sekularizmi u bë vlerë, përkatësia etnike nuk arriti të bëjë atë.

Multikulturalizmi dhe Maqedonia (Marrëveshja Kornizë e Ohrit)

Multikulturalizmi si parim mbi të cilin shoqëria do të strukturohet ishte përcaktuar në vitin 2001 me anë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit që inkorporohej në gjitha sferat e ligjeve dhe i plotësonte kërkesat e bashkësive etnike të cilat konsideronin që Kushtetuta e vitit 1991 ka bërë lëshime në lidhje me të drejtat e tyre, si dhe me kushtetutat e mëhershme të RSM-së.⁸

Preambula e Kushtetutës së RSM-së (Republika Sociale e Maqedonisë) përcakton vendin si një shtet nacional të popullit maqedonase dhe shtet i nacionaliteteve shqiptare dhe turke. Nga ana tjetër, Preambula e Kushtetutës së vitit 1991 deklaron si historike faktin që Maqedonia është përbërë si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilën siguron barazi të plotë qytetare dhe bashkëjetesë të përhershme të popullit maqedonase me shqiptarët, turqit, romët dhe nacionalitete tjera të cilat jetojnë në Maqedoni (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991). Kjo pakënaqësi dhe mungesa e të drejtave të veçanta kolektive rezultoi me konflikt të armatosur në vitin 2001, që me ndërmjetësimin e forcave ndërkombëtare ishte zgjedhur dhe përmbledhur në Marrëveshje Kornizë me çfarë u hap një kapitull i ri i shoqërisë maqedonase në të cilën vlera më e madhe është toleranca dhe bashkëjetesa. E nënshkruar më 13 gusht 2001. Disa vite pas nënshkrimit të Marrëveshjes, ligje të reja për vetëqeverisje lokale dhe organizim territorial ishin miratuar sepse mendohej që ndarja aktuale e komunave nuk është e përshtatshme për situatën shoqërore. Ishin korrigjuar kufijtë e më tepër komunave me qëllim që të mund minoritetet të gjenerojnë të drejtat e tyre kolektive në bazë të përfaqësimit procentual, që u tregua si vendimtare që të bëhen në dispozicion disa të drejta të caktuara. Për të përmirësuar besimin në aparatin e detyruar të këshillave lokale të vendit, ishte përcaktuar që të kenë të drejtë të zgjedhin krye shëfat e policisë, të propozuar nga Ministria e Punëve të brendshme, por edhe në saj të nëpunësve policor të caktohet që duhet të punësohen pjesëtarë të komuniteteve minoritet të cilët përveç përkatësisë do të tregohen edhe si kuadro cilësor. Gjatë kësaj, jo vetëm që nuk konfirmuar jo-diskriminimi por edhe u konfirmua përfaqësimi reciprok i bashkësive etnike në gjitha sferat e shoqërisë. Nëse flasim për të drejtën e përdorimit të gjuhës ishte konstatuar që të gjithë pjesëtarët komuniteteve minoritet kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e tyre amtare, gjegjësisht në arsimin fillor dhe të mesëm, ndërsa shteti do të financojë arsimin e lartë ku 20% flitet në gjuhë që nuk është maqedonishte. Atë që mund të themi është se

⁸"Marrëveshja Kornizë e Ohrit 2001", <http://mls.gov.mk/index.php?category=15>
Accessed 09.20, 2014.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

marrëveshja jo vetëm që nuk mbeti në letër por ishte inkorporuar në sajë të Kushtetutës. Shteti përcaktohej si multietnike dhe me sukses jepte përgjigje nevojave të minoriteteve, i konfirmoi dhe inkorporoi të drejtat kolektive të bashkësive por edhe morri për obligim avancimin e mëtutjeshëm në mënyrë paqësore dhe me anë të negociatave varësisht nga nevojat dhe gjendjeve.⁹

Konkluzion:

Shoqëritë e sotme gjegjësisht shtetet gjenden para sfidës nëse të pranojnë një prej tendencave më kryesore në lidhje me të drejtat e njeriut. Në fakt, nëse të pranojnë parimin amerikan të të drejtave universale ku pavarësisht nga përkatësia etnike të gjithë gëzojnë të drejta të barabarta pas të cilave gjendet shtetit dhe organizatat ndërkombëtare ose parimi i ri i specifik posaçërisht për shtetet evropiane ku entiteteve minoritet më të vogla ju garantohen të drejta kolektive të cilat përveç atyre individuale kanë për qëllim të përmirësojnë pozitën e minoriteteve.

Ka shumë dokumente që mbrojnë njërin ose tjetrin parim por sërish më e pranueshme është mesi i këtyre dy qasjeve të përmendura më lartë. Fillimisht, secili shtet duhet të respektojë, proklamojë, zhvillojë të drejtat individuale të njeriut të përcaktuar me anë të shumë dokumenteve për të inkorporuar nëse është e mundshme në kushtetutën ose ligjet, të qëndrojnë me aparatit e detyrimit pas tre me qëllim të realizimit të plotë por edhe mos të harrojnë të mbrojnë interesat e minoriteteve nga mazhoranca. Vetëm me kushtet e tilla mundësohet funksionim i gjatë dhe i qetë i shoqërisë.

Nëse bëhet injorim i njërit ose tjetrit lloj të të drejtave mund të rezultojë me turbulenca politike të cilat shpeshherë kanë qenë fatale për qeniet njerëzore dhe për funksionimin e shteteve.

⁹"Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991",

<http://www.sobranie.mk/?ItemID=A431BEE83F63594B8FE11DA66C97BEAF>, Accessed 09.20,

2013.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Bibliografia:

1. Brems, Eva. *Human Rights: Universality and Diversity*. Martinus Nijhoff Publishers, 2001.
2. Claude, Richard Pierre, and Burns H. Weston. *Human Rights in the World Community: Issues And Action*. University of Pennsylvania Press, 2006.
3. Kymlicka, Will. *Multicultural Citizenship: A Liberal Theory of Minority Rights*. Oxford University Press, 2003.
4. Will Kymlicka, "Immigration, citizenship, multiculturalism: exploring the links", *Political Quarterly*, Vol. 74 (2003), 195-208.
5. Virginia. *The Constitution of Virginia: Together with the Virginia Bill of Rights, Passed June 12, 1776*. Printed at the office of the New nation, 1867.
6. "The Universal Declaration of Human Rights." Accessed 09.21, 2014
7. <http://www.un.org/en/documents/udhr/>
8. "European Convention of Human Rights" Accessed 09.21, 2014 <http://conventions.coe.int/treaty/en/treaties/html/005.htm>
9. "Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991" Accessed 09.20, 2013 <http://www.sobranie.mk/?ItemID=A431BEE83F63594B8FE11DA66C97BEA>
10. "Marrëveshja Kornizë e Ohrit 2001" Accessed 09.20, 2014 <http://mls.gov.mk/index.php?category=15>
11. ¹"Magna carta (The Great Charter)" Accessed 09.21, 2014 <http://www.constitution.org/eng/magnacar.htm>.

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Grupi i punës 5:

Bogoeva Katalin
Gjorgjievski Marko
Stojmenov Aleksandar
Çorlinova Nikolija

Uzurpimi i sekularizmit nga religjionet shtetërore?

Hyrje

Religjioni ka një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të njerëzve. Ai çdo ditë ndryshon dhe përshtatet rrethanave shoqërore dhe politike. Për dallim nga shumë mendimet e ekspertëve, religjioni nuk është zhdukur, por në fakt ajo luan një rol të rëndësishëm në jetën e njerëzve dhe ka evoluar dhe rinovuar në rrethanat e reja shoqërore dhe politike.

"Në periudhën pas vitit 1945, gjegjësisht periudhë në të cilën Maqedonia është një republikë në sajë të Jugosllavisë Federale është shënuar një sekularizëm i fuqishëm. Një prej postulateve të vetë federatës ka qenë edhe ateizmi marksist. Në kohë kur ateizmi ka qenë një prej postulateve kryesore të vetë shtetit, roli i bashkësive fetare ishte zvogëluar në minimum. Në këtë model sekular ndikim më të madh ka pasur marksizmi, leninizmi, dhe ateizmi marksist që përmendëm më lartë, por edhe ka themeluar ideologjinë e klasës punëtore ose proletariatit."¹

Në periudhën pas ASNOM-it zbatohen postulatet ideologjike si në niveli federal ashtu edhe në atë republikan. Ndonëse Deklarata për të Drejtat Themelore nga ASNOM ka qenë "liria e garantuar e konfesionit për secilin qytetar"², gjithnjë e më tepër parashtrohej pyetja e rolit të organizatave fetare dhe me atë gjithnjë e më tepër ju ishte pamundësuar e drejta e konfesionit për qytetarët. Me rëndësi është të theksohet që në kohën kur ky model sekular zbatohet ishin marrë shumë të drejtat të bashkësive fetare, dhe me atë edhe të vetë qytetarëve. Me Ligjin për Gjendjen Juridike të Bashkësive Fetare ishin shkurtuar disa prej kompetencave si niqahu, akti fetar i pagëzimit dhe syneti.

Paradoksale është që në këtë periudhë kushtetutat në nivelin federal dhe republikan kanë qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, ndërsa ligjet dhe aktet nënligjore kanë qenë në asnjë nivel me standardet ndërkombëtare.

¹Vuko Paviçević, "Marksizmi dhe Religjioni", shkarkuar nga:

<https://www.scribd.com/doc/129577157/Марксизмот-и-религијата>

²Shkarkuar nga: http://mk.wikisource.org/wiki/ACHOM_документ_9

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Të gjitha këto ngjarje e ndjekin pasqyrën heterogjene maqedonase të bashkësive fetare. Në pjesën tjetër të punimit jemi fokusuar në kontrollimin se çfarë modeli i takon Maqedonisë me sqarim paraprak të modeleve të religjionit shtetëror dhe sekularizmit.

Religjioni shtetëror

"Ka një dallim delikat mes shteteve religjioze dhe religjionet shtetërore. Shtetet religjioze janë ata në të cilat religjioni kontrollon shtetin ose qeverinë. Tek religjionet aktive shtetërore, shteti mbështet religjionin, por në të njëjtën kohë edhe mban distancën e duhur."³

Në fund të shekullit XIX, nacionalizmi zëvendëson vlerat e bazuara në religjion si një fuqi lidhëse e shoqërisë. Megjithatë, situata sërish ndryshon në gjysmën e dytë të shekullit XX ku nacionalizmi religjioz merr një hov të madh. Rasti konkret është Irani, kur qeveria sekulare është zëvendësuar me nacionalistët islamik, ndërsa kohëve të fundit jemi dëshmitarë të rritjes dhe ndikimit të hindu -nacionalizmit në Indi dhe judaizmit ultra-ortodoks në Izrael.

Shkalla dhe natyra e mbështetjes së shtetit ndaj konfesionit të caktuar si religjion shtetëror mund të dukshëm të ndryshojë. Mund të jetë nga mbështetja më e thjeshtë (me ose pa mbështetje financiare) me liri të praktikohen fetë tjera, deri në ndalesë për gjitha organet tjera detare madje edhe persekutim të ndjekësve të feve ose sekteve tjera.

"Përveç kësaj, ekziston edhe dallim mes "kishës shtetërore" dhe terminit më të gjerë të "religjionit shtetëror". Kisha shtetërore është religjioni shtetëror i krijuar nga ana e shtetit për përdorim vetme nga ky shtet. Shembull për religjionin shtetëror dhe njëherë edhe kishë shtetërore është katolicizmi romak në Kosta Rika, që është pranuar si religjion shtetëror me kushtetutë, ndonëse nuk ka kishë nacionale. Në rastin me kishë shtetërore, shteti ka kontroll të plotë mbi kishën, dhe në atë rast religjioni shtetëror është drejtuar nga një organ i jashtëm (në rastin me katolicizmin, Vatikani ka kontrollin mbi kishën). Megjithatë, në dy rastet, religjioni zyrtar i shtetit ka një ndikim të caktuar mbi shtetin."⁴

Ka një dallim të madh në relacionet mes shtetit dhe religjionit, por ka edhe disa ngjashmëri të përbashkëta. Në kuptimin historik, shtetet kanë dhënë përparësi një religjioni mbi tjetrën, dhe secili shtet ka politikën personale ndaj religjionit. Shtetet e shohin nevojën për të ndihmuar qytetarëve të tyre nga religjionet të cilat ata konsiderojnë se janë të rrezikshme. Në shumë shtete, religjioni është lidhur me identitetin nacional, posaçërisht shtetet me popullatë dominuese myslimane. Religjionet dhe institucionet religjioze shpeshherë kanë lidhje simbolike me shtetin, sepse secila nga ata e ndihmon tjetrën.

Religjioni edhe më tutje ka ndikim të dukshëm mbi shoqërinë dhe politikën dhe shtetin.

³ Peta Goldberg, Patricia Bundel, Trevor Jordan, *Investigatin religion: Chapter I, Religion-State Relationships*, Cambridge, Cambridge University Press, 2009

⁴Shkarkuar nga: http://en.wikipedia.org/wiki/State_religion

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Sekularizmi

"Sekularizmin mund të definojmë shkurtimisht si ndarje të religjionit nga pushteti, gjegjësisht ulja e pranisë së religjionit në shtetin, kulturën, artin, pushtetin, arsimin, politikën, etj.

Sekulariteti e aprovon të drejtën për të qenë i liruar nga sundimi fetar dhe mësimi si dhe e drejta e lirisë së imponimit të religjionit tek njerëzit nga qeveria e shtetit që është neutrale në lidhje me çështjet e lidhura me fenë."⁵

"Rrënjët e ndarjes së fuqishme të shtetit nga kisha janë nga revolucioni francez kur në mënyrë brutale eliminohet kisha e atëhershme ndikuese katolike nga pushteti ekzekutiv dhe gjyqësor. Kryeministrja franceze Emili Komb në vitin 1905 miraton një ligj me të cilin përcaktohet qartë sekularizmi. Përskaj shtypjeve fillestare, rezistencave dhe padive në Gjykatën Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut, ligji edhe më sot funksionon mirë dhe reziston gjitha shtypjeve."⁶

"Sekularizmi në shoqërinë është përhapur nëpërmjet tre ideologjive:

1. Liberalizmit, në kohën e kulimit të saj janë ekzekutuar qindra prift dhe mijëra besimtarë, pa procese gjyqësore;
2. Komunizmit, në gjithë Evropën Lindore, si dhe në Meksikë ka bërë aksidente të mëdha për krishterimin dhe ka bërë persekutimin;
3. Nazizmit, një prej mënyrave më brutale të zhdukjes, ku ishin hapur kapmë koncentrimi dhe janë torturuar dhe vrarë viktima të pafajshëm."⁷

Nga këto ideologji, dy janë shpërbërë, ashtu që ka mbetur vetëm liberalizmi që karakterizohet me veprim kundër ideologjisë fetare, ndërsa ajo nënkupton që nga kjo më shpejtë krijohet ateizmi, që është mjaft i afërt me sekularizmin. Ashtu, sekularizimi ka filluar në mënyrë masive të përhapet dhe të humbet rëndësia dhe domethënia e krishterimit dhe fesë dhe janë krijuar shoqëri në mungesë të fesë ose shoqëri sekulare.

Shoqëritë sekulare dallohen nga relacioni i tyre ndaj religjionit dhe politikës ose mund të thuhet edhe sekularizëm radikal (Francë), që përjashton çdo përzjerje të pushteteve politike në punët e brendshme të kishës dhe çdo ndikim i saj në hapësirën publike.

⁵Shkarkuar nga:

<http://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%A1%D0%B5%D0%BA%D1%83%D0%BB%D0%B0%D1%80%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82>

⁶Ratomir Grozdanoski, "Sekularizmi dhe sekularizimi", ligjëratë e forumit njëditësh me profesorë eminentë dhe mendimtarë; 25.06.2007, Shkup

⁷Rom 10,12; Gal. 3,28; Kor. 12, 13; Mat 5,9; 1.Pje.2, 10; 1. Gjon 3,1; 5,2; Rom 8,16

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Rasti maqedonas

Në lidhje me çështjet e marrëdhënieve mes bashkësive fetare dhe grupeve religjioze edhe në këtë kuptim garancitë për liritë fetar dhe të drejtat, Republika e Maqedonisë ka krijuar një model që mbështetet në:

1. Standardet ndërkombëtare perëndimore-evropiane;
2. Traditat e popullatës shumicë;
3. Realitetet e peizazhit aktual fetar.

Kushtetuta e përcakton Republikën e Maqedonisë si sekulare e Nenin 19, Paragrafin 3. Gjegjësisht, dispozita e nenit të përmendur për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze sipas definicionit "...janë të ndara nga shtetit dhe janë të barabartë para ligjit". Të njëjtën dispozitë e kemi edhe në Ligjin për Pozitën Ligjore të Kishës, Bashkësisë Fetare dhe Grupit Religjioz (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 113/07) me të cilën realizohet përputhje e ligjit përkatës me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Ky lloj i sekularizmit vihet në pikëpyetje nga fakti që në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë janë theksuar "Kisha Ortodokse Maqedonase si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Metodiste-Evangjelike, Bashkësia Hebraike..." me të cilën përcaktohet aspekti sekular i vendit.

Aspekti historik-ligjor i Nenit 19 të Kushtetutës është interesant. Më 17 nëntor 1991 me miratimin e aktit më të lartë ligjor në Republikën e Maqedonisë përveç ndarjes së shprehur të religjionit është bërë edhe kundërshtim. Versioni i atëhershëm i Nenit 19 ka qenë: "Kisha Ortodokse Maqedonase, bashkësitë tjera fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabartë par ligjit". Uzurpimi i sekularizmit është evidente ku në një fjali jepet përparësi Kishës Ortodokse Maqedonase në krahasim me bashkësitë tjera fetare dhe grupe religjioze.

Neni 19 ka mbetur i tillë deri në miratimin e Marrëveshjes Kornizë ku në Aneksin A kanë qenë të propozuar amendamentet kushtetuese, në rastin konkret Amendamenti VII. Andaj, paragrafi 3 i nenit 19 për momentin duket kështu: "Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Metodiste-Evangjelike, Bashkësia Hebraike dhe bashkësitë tjera fetare dhe grupe religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabartë para ligjit".

Uzurpimi i sekularizmit sërish paraqitet, por jo me një por me 5 kisha.⁸Sërish, dhënia e përparësisë për Kishën Ortodokse në krahasim me kishat tjera, bashkësitë fetare dhe grupe religjioze mbetet dhe dallohet me termin, ..., si dhe".

⁸Ligji për Pozitën Ligjore të Kishës, Bashkësisë Fetare dhe Grupit Religjioz (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 113/07) në nenin 2, paragrafin 1, termi "kishë" nuk e trajton vetëm si objekt fetare por si një bashkësi vullnetare e personave fizik që me bindjen e tyre fetare dhe burimet e mësimi të tyre e realizojnë lirinë e konfesionit të bashkuar ë fe dhe identitet të shprehur kryerjen e barabartë të shërbimit, lutjeve, zakoneve dhe shprehjes së fesë.

**SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"**

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Me vendim të Gjykatës Kushtetuese (U. nr. 104/09) theksohet që "nuk ekziston religjion shtetëror e cilat do të jetë më e privilegjuar dhe nuk njihet asgjë për asnjë fe në asnjë lloj baze". Megjithatë, sfida e modelit maqedonas të sekularizmit përbëhet në mençurinë e sigurimit të baraspeshës mes bashkësive më të mëdha fetare ndonëse janë me numër të ndryshme të besimtarëve.

Përbërja e rregulluar në këtë mënyrë ideologjike-politike është produkt i gjendjes në Republikën e Maqedonisë, që nuk është një shtet homogjen fetar. Pjesa themelore e të drejtave, si dhe garancitë e lirisë së konfesionit janë në nivel të standardeve të pranueshme demokratike. Theksimi i disa konfesioneve në krahasim me tjerat nuk është indikator për kapacitetet demokratike të një shteti të caktuar, por hap një fushë të rishqyrtimit të barazisë.

Konkluzion

Ky punim i shkurtë hulumtues kishte për synim të prezantojë historinë e shkurtë të bashkësive fetare në Maqedoni, nga koha e përfitimit të shtetësisë në vitin 1944 deri më ditën e sotme. Gjithashtu, është dhënë definicion për modelin e religjionit shtetëror dhe modelin e sekularizmit dhe prezantohet pasqyra e vërtetë, gjegjësisht pozita ligjore e kishës, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze.

Duke marrë parasysh traditat nga RSFJ de peizazhit heterogjen të bashkësive fetare që pasqyron situatën e ndërlikuar në të cilën gjendet sot Maqedonia, dhënia e përparësisë së një ose më tepër religjioneve në krahasim me tjerat e vendos në pyetje modelin e sekularizmit në Republikën e Maqedonisë.

Përcaktimi i modelit në Maqedoni akoma zhvillohet me vështirësi. Maqedonia stacionohet mes modelit të religjionit shtetëror dhe modelit të sekularizmit. Kjo tregon që uzurpimi i religjioneve shtetërore mbi sekularizmin është me rëndësi të madhe për përcaktimin ose mos-përcaktimin e statusit kushtetues ligjor të religjioneve.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Bibliografia

1. Aktet Konstituive të ASNOM. Shkarkuar nga: <http://za-makedonija.blogspot.com/2013/11/akti-na-asnom.html>;
2. Vendim i Gjykatës Kushtetuese (U. Nr. 104/09), pika 5. Shkarkuar nga: <http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=753>;
3. Ratomir Grozdanoski, "Sekularizmi dhe sekularizimi", ligjëratë e forumit njëditësh me profesorë eminentë dhe mendimtarë; 25.06.2007, Shkup, <http://www.rrgrozdanoski.mk/content/view/206/124/lang,macedonian/>
4. Peta Goldberg, Patricia Bundel, Trevor Jordan, Investigatin religion: Chapter I, Religion-State Relationships, Cambridge University Press, 2009;
5. Marrëveshja Kornizë, Aneksi A – ndrysim i nenit 19. Shkarkuar nga: <http://www.mls.gov.mk/index.php/2014-09-28-15-17-37/70-2014-09-28-12-12-00>;
6. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 113/07, neni 19 paragrafi 3. Shkarkuar nga: <http://www.pravo.org.mk/documentDetail.php?id=753>;
7. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Shkarkuar nga: <http://www.sobranie.mk/ustav-na-rm.nspx>;
8. Ustavni zakon o osnovama društvenog i političkog uređenja Federativne Narodne Republike Jugoslavije i saveznim organima vlasti, 13. januar 1953;
9. Maqedonia Federale në Jugosllavinë Federale. Shkarkuar nga: <http://za-makedonija.blogspot.com/2013/12/federalna-makedonija-1945-91.html>.

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Grupi i punës 6:

Marija Antova
Florina Emini
Lucija Kashuba
Filip Tanqev

Realiteti maqedonas: Ndarje etnike ose religjioze?

Individi, grupet dhe kombet kanë pasur një qëllim të vetëm thelbësor, të mbijetojnë si të tillë, autentik secili për veten. Vetëm atëherë ë njëjtët do kishin mundur edhe të zhvillohen. Në të kundërtën, kanë skenarin e vetëm të mundshëm, të asimilohen, të absorbohen nga të ndryshmit dhe thjeshtë të zhduken. Logjika thotë se sa më të mëdha janë dallimet mes grupeve, intensiteti i konflikteve, sipas çfarëdo baze, do të jetë proporcionalisht e anasjelltë. Por si shumë sende tjera, jo gjithmonë logjika jonë përputhet me realitetin. Konstatimi i tillë ka realizuar suksesshëm kulmin e vet në politikë si segment shoqëror. Akoma më shumë në shoqëri si ajo maqedonase. Një copë tokë me tradita, kultura dhe histori të shumë popujve, ku për këtë shkak nuk ka tërësi të pastër homogjene. Këtu diku do të gjejmë përgjigje: pse edhe përskaaj dallimeve të mëdha të grupeve në Republikën e Maqedonisë, ata janë në konflikt të përhershëm? A është ndarja faktike pasojë e individit, pasojë e përkatësisë së ndryshme etnike të individit, që në fund të fundit e ndjenë si identitet të vet themelor ose shkohet më larg? E fundit domethënë, a krijohet stereotipizim i individit sipas religjionit që manifestohet nëpërmjet ndarjes faktike që rritet vazhdimisht mes qytetarëve maqedonas. Tema ka rëndësi kyçe për zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjella mes anëtarëve të grupeve që drejtpërdrejtë do të ndikojnë përgjithësisht në zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore. Ndarja, në bazë të religjionit ose përkatësisë etnike, do të ketë ndikime të drejtpërdrejta mbi ngjarjet e përgjithshme që janë burim i mundshëm për konflikte më të mëdha, të cilat shoqëritë në tranzicion si shoqëria maqedonase nuk dihet se a mund të ja lejojnë vetes.

Për zgjedhjen e çfarëdo pyetje duhet të qartësohen gjërat në bazë ose të zërthehen momentet kontestuese me anë të përcaktimit të nocionit, dhe me qëllim që më mirë të gjendet burimi i kontestit. Në rastin tonë kjo do të ishte një analizë e shkurtë i përcaktimit të nocionit të përkatësisë etnike dhe religjioze, gjetjen e dallimeve mes tyre nga njëra anë

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

dhe gjetjen e emëruesit të përbashkët mes grupeve të ndryshme nga ana tjetër.

Do të nisim me minoritetet duke ju referuar Rekomandimit 1201 të Këshilli të Evropës. Ata janë numër më i vogël përfaqësues i qytetarëve me shtet konkret që kanë tipare të dalluara gjuhësore, fetare ose kulturore krahasuar me shumicën e popullatës në shtet dhe janë të motivuar të ruajnë identitetin e përbashkët sipas ndjenjës së solidaritetit.¹ Minoritetet në përgjithësi janë të ndarë sipas tre bazave, gjegjësisht kemi minoritete etnike, gjuhësore dhe religjioze. Siç thamë individ i njej identitetin e tij themelor në përkatësinë e vet etnike ndaj grupit pasi që kjo edhe e jep përgjigjen, kush është ai dhe ku e ka vendin në shoqëri. Pikërisht për këtë shkak është e rëndësishme që grupi etnik të shihet si i ndryshëm, i njohur dhe i pranuar me dinjitet.² Në këtë rast kufiri dhe jo ngjashmëria paraqet nocionin më të rëndësishëm për konsolidim të grupit etnik.

Sipas Kushtetutës³, në Republikën e Maqedonisë individëve ju garantohet mbrojtja e identitetit etnik, gjuhësor dhe fetar si pjesëtar të bashkësive të ndryshme. Kjo vetëm vërteton faktin që shoqëria maqedonase është pluraliste. Në këto shoqëri zakonisht ekziston ndjenje e pasigurisë tek anëtarët e grupit nga cenimi i mundshëm ose kërcënimi nga mazhoranca. Ka disa lloje që së bashku mund të parandalojnë rritjen e ndjenjës së pasigurisë, e cila mund të shndërrohet në burim konfliktesh. Pranimi dhe respektimi i vlerave të ndryshme, pjesëmarrja në miratimin e vendimeve politike dhe ndarja përkatëse e resurseve janë kyçe për minimizimin e përçarjes. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit në vitin 2001, në Republikën e Maqedonisë parashihen masa me të cilat mundet kategorikisht të përmirësohet gjendja e minoriteteve. Përfitime më të mëdha nga kjo do të ketë bashkësia shqiptare si grup më i madh etnik në Republikën e Maqedonisë. Nuk do të futemi në tema me të cilat duhet të përcaktohet nëse Marrëveshja kornizë zbatohet në mënyrë përkatëse dhe deri në fund. Vetëm do të përmendim faktin se çdo ditë ndarja sipas bazës etnike mes popullatës shqiptare dhe shumicës është më e madhe. Ky është tregues i drejtimit në të cilin zhvillohet shoqëria maqedonase.

Edhe sikur kjo nuk mjafton, individë të udhëhequr sipas kriterëve të ndryshme për të vërtetën veprojnë në drejtim të çrregullimit të dialogut etnik, që vetëm më është delikat. Këtu gjejmë edhe shkakun e brengosjes sonë. Gjegjësisht, a ka kushte që ndarja në baza etnike të transferohet në fushën e religjionit? A mundet kriza e identitetit të grupit të tejkalon kufirin etnik dhe të transferohet në natyrë religjioze?

Jo rrallë identiteti etnik, si nocion më i gjerë, përveç historisë së përbashkët, traditës dhe kulturës përfshinë edhe religjionin e përbashkët. Andaj kjo paraqet një shkak më shumë që të jetë i aftë të angazhon ndjenjat më intensive, më të thella dhe më personale të njeriut. Por, ndodh

¹Doc. Dr. Andeva Marina, Punëtori: "Marrëdhëniet Inter-Etnike dhe të Drejtat e Minoriteteve", Shkup: Universiteti "Evro-Ballkan" shtator 2014, fq. 4

²Prof. Dr. Danaillov Fërçkovski, Ljubomir, "Negocimi në konflikte të Identitetit". Shkup: Templum, 2007, fq. 28

³Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 48, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, 17 nëntor 1991

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

edhe grupet në një shoqëri të definojnë si pakica vetëm në baza religjioze, që nuk e ul nivelin e ndjeshmërisë. Ky nuk është rasti me Republikën e Maqedonisë ku pakicat janë të definuar në baza etnike që absorbon edhe të drejtën e praktikimit të lirshëm të religjioneve të tyre.

Fjalët që i paraprijnë termit religjion si të tillë kanë shënuar „lidhje të fortë të gjërave“ që në të kaluarën edhe ka manifestuar rolin e saj –të lidh grup më të madh njerëzish në një vend, me një qëllim.⁴ Religjionet këtë funksion kanë edhe sot por zakonisht si nocion përdoret që të shënon besimet, sjelljet dhe institucionet shoqërore të lidhura me mendimet mbi origjinën, kuptimin dhe rëndësinë e kësaj jete dhe jetës pas vdekjes. Ose, thënë ndryshe, diku në shekullin e shtatëmbëdhjetë paraqiten dallimet mes asaj që është publike dhe intime. Roli i religjionit, sipas të cilit është përcaktuar statusi dhe pozita e individit, është bërë çështje intime ose thelb i brendshëm i besimit. Më konkretisht, në shekullin e shtatëmbëdhjetë dobësohet rëndësia e religjionit në krahasim me shoqërinë, gjegjësisht me Revolucionin francez përfundimisht themelohet shteti sekular. Në këtë kontekst si kundërshtim mund të përmendim procesin e sakralizimit (de-sekularizëm) në të cilin feja ka rëndësi më të madhe. Ky proces është mjaft aktiv në botë dhe lidhet me kolonitë e mëparshme dhe përcaktimin e identitetit të tyre të pavarur.⁵ Por nuk lidhet me demokracitë perëndimore tash më disa shekuj nuk ka nevojë për këtë.

Republika e Maqedonisë është shtet sekular por mbështetet mbi parimet etike të cilat janë të duhura për religjionin dominues nga njëra anë, ndërsa nga tjetra qytetarët janë të lirë në marrjen e vendimeve se në cilën organizatë fetare do të marrin pjesë. Kjo e dyta është tërësisht legjitime duke marrë parasysh rinovimin e lidhjes mes religjionit dhe shtetit në mes të shekullit njëzet. Ndërveprimi i rinovuar ka qenë si pasojë e zhgënjimit të vlerave hyjnore dhe aksidentet që kanë ndodhur pjesën e parë të shekullit paraprak.

Si konkluzion, nga shqyrtimi i shkurtë i religjionit do të jetë e mjaftueshme vetëm një fjali. Pavarësisht nëse është proces aktiv i sekularizmit ose sakralizmit, e pamundur është që religjioni dhe shtetit të shikohen si dukuri tërësisht të ndara.

Nëse kthehemi në shoqërinë maqedonase në tranzicion, në konstatimin e parë ka frikë për ndarje potenciale religjioze. Komuniteti shqiptar që është më e madhe, si religjion dominues e ka islamin, ndërsa shumica ka krishterimin ortodoks. Ndarja faktike në bazë të përkatësisë etnike shumë lehtë mund të transformohet në ndarje në bazë religjioze. Politika e brendshme ose mënyra me të cilën organizohet jeta shoqërore është me rëndësi të madhe për atë nëse do të realizohet ky supozim ose jo. Religjioni që ka rëndësi intime për individin është ekspozuar në manipulime nga politika si një segment më pragmatik i renditjes shoqërore. Gjegjësisht, gjatë viteve të fundit jemi dëshmitarë jo vetëm të situatave kontestuese por madje edhe konfliktuozë si pasojë e përkatësisë etnike të palëve në konfrontim. Të gjitha këto ndodhi kanë edhe notë religjioze. Çfarë do të

⁴Patrik K, "Manuali i ri i Lajanit, Religjione në Botë". Shkup, Mlladinska kniga, 2009, 10

⁵Ibid.,445.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

thotë ajo? Gjithnjë e më tepër çështjet religjioze janë temë për përleshje mes grupeve ndonëse organizatat fetare në Republikën e Maqedonas nuk kanë relacione kontestuese dhe në fakt secili religjion është paqësor. Si ilustrim do të përmendim përleshjet në lidhje me objektet fetare si të Bashkësisë Islame ashtu edhe të Kishës Ortodokse. Dhuna që nuk praktikohet nuk është e lejueshme për një shtet që ka për qëllim të bëhet pjesë e familjes evropiane dhe nga ana tjetër deklarohet si demokratike.

Ky lloj konfrontimi për shkak të religjionit dhe praktikimi në mesin e pjesëtarëve të minoriteteve etnike dhe mazhorancës i vendos në një shportë edhe ata besimtarë që nuk janë pjesë e asnjërës ose të tjerët që kanë përcaktimin e njëjtë fetar në mënyrë përkatëse. Pasojat të cilat ndodhin, qenë pozitive ose negative, ndikojnë në përgjithësi mbi gjithë komunitetin fetar andaj nga kjo të gjithë i gëzojnë përfitimet ose vuajnë humbjet pavarësisht nga kontributi i tyre personal. Paraqitja faktike e përleshjeve në emër të religjionit është tepër alarmante nga arsye që do të thotë kthim jo vetëm në një hap por në disa hapa mbrapa. Për shkak të natyrës intime që ka religjioni për individin shumë lehtë mund të vije deri në eskalimin e gjendjes e cila do të ushqehet nga mosbesimi reciprok i dy palëve. Madje, në një shoqëri që ende nuk ka stabilitetin që kërkon globalizimi. Shoqëria maqedonase është njëra prej atyre.

Nga e gjithë ajo që ishte përmendur më lartë, konkluzioni është që ndarja aktuale etnike në Republikën e Maqedonisë shumë lehtë mund të bëhet edhe ndarje religjioze që do të jetë shkatërruese për gjithë shoqërinë. Disa prej mënyrave me të cilat do të tejkalohet ky realitet është koncepti i shoqërisë multikulturore ose koncepti i kosmoplitanizmit. Me të parin, është një koncept që zbatohet në shoqëri ku ka pluralizëm të ndërlikuar kulturor, tejkalohet dominanca e madhe e matricës kulturore e mazhorancës që do të thotë se politika shtetërore dhe instrumentet e saja nuk mund të vendoset hegjemoni nga mazhoranca. Me këtë koncept do të mund të arrihet konsensus më të gjerë mbi dallimet që nga ana tjetër është një sfidë e madhe.⁶ Koncepti i kosmoplitanizmit për maksimë ka njohjen e dallimeve. Me këtë koncept braktiset trajtimi në hierarki për dallimet, por qëllimi është që edhe ato mos të largohet por të pranohen si të tilla dhe madje pastaj të vlerësohen pozitive.⁷ Të dy konceptet kanë anë negative por ajo nuk i ndikon përfitimet të cilat do të afronin shoqërinë drejt harmonizimit.

Për fund, do të shtonim që pa marrë parasysh nëse konceptet e përmendura më lartë ose diçka tërësisht tjetër do të zbatohet për tejkalimin e gjendjes status quo, në gjitha situatat rol të rëndësishëm luajnë pjekuria ekonomike, politike dhe sociale e shoqërisë ose thënë më mirë pjekuria e qytetarëve. Në Republikën e Maqedonisë vërehet dukshëm që ky faktor mungon.

⁶Ljubomir Ferçkovski *Negocimi në konflikte të Identitetit*, Templum, Shkup, 2007, 58

⁷Aleksandar Spasov. *Sovraniteti shtetëror në kontekst të proceseve të globalizimit* Shkup, 2010, 107.

SHKOLLA VERORE: "RELIGJIONI, PËRKATËSIA
ETNIKE DHE NACIONALIZMI"

15 – 19 shtator 2014

Shkup, R. e Maqedonisë

Bibliografia:

1. Prof. Dr. Danaillov Fërçkovski, Ljubomir, "Negocimi në konflikte të Identitetit". Shkup: Templum, 2007.
2. Patrik K, "Manuali i ri i Lajanit, Religjione në Botë". Shkup, Mlladinska kniga, Shkup, 2009
3. Spasov Aleksandar, *Sovraniteti shtetëror në kontekst të proceseve të globalizimit*" Shkup, 2010.
4. *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*



Konrad
Adenauer
Stiftung

*Qëndrimet dhe konkluzionet e dhënë në punimet janë vetëm të autorëve
dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyrojnë qëndrimet dhe konkluzionet e
organizatorëve të shkollës verore.*

Fondacioni Konrad Adenauer

Projekti: "Religjioni, Përkatësia
Etnike dhe Nacionalizmi"

Maksim Gorki 16/kati 3
Republika e Maqedonisë
1000 Shkup

Telefon: +389 (2) 323 1122

Faks: +389 (2) 313 5290

Skopje@kas.de

www.kas.de/mazedonien



Universiteti "Evro-Balkan"

Bul. Arradhat Partizane 63 1000
Shkup, Maqedoni

Tel: +389 2 3075 570

Faks: +389 2 3090 731

contact@euba.edu.mk

www.euba.edu.mk